

RAPORTI I PAJTUESHMËRISË OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRDARJES

2023

Ky raport është përgatitur në bazë të informacionit që është vënë në dispozicion nga Operatori i Sistemit të Shpërdarjes OSSH Sha, Zyrtarit të Pajtueshmërisë së Shoqërisë gjatë përbushjes së përgjegjësisë të tij në vitin 2023

Përgatiti:

Ervis Hazizi

Zyrtari i Pajtueshmërisë

E-mail: ervis.hazizi@ossh.al

Website: www.ossh.al

Përmbajtja

1. Hyrje	3
2. Modeli Administrativ: “Operator i Sistemit të Shpërndarjes”	4
3. Kush jemi ne OSSH: “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes”	8
4. Programi i Pajtuëshmërisë OSSH	11
5. Ndarja e aktivitetit të OSSH Sh.a.	14
6. Përjashtimi i sjelljes diskriminuese	21
7. Konkurrenca dhe marrëdhëniet komerciale	23
8. Zbatimet e transparencës, paanshmërisë të trajimin e ankesave për përdoruesit e rrjetit	25
9. E drejta e informimit dhe inovacioni	26
10. Ruajtja e konfidencialitetit të informacioneve të ndjeshme	30
11. Ofrimi i Shërbimeve të Përbashkëta	31
12. Alokimi i kostos në OSSH	33
13. Zbatimi i Programit të Pajtuëshmërisë	34
14. Humbjet totale në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2023	35
15. Operimi i rrjetit	40
16. Investime të kryera në rrjet sipas planit të Investimeve dhe remontet e kryera	45
17. Informacion mbi lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes	47
18. Zbatimet dhe rekomandimet e Zyrtarit	54
19. Konkluzione	56

Raporti i Pajtueshmërisë 2023

OSSH

1. HYRJE

Ky raport hartohet në bazë të nenit 16 dhe nenit 72, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 135/8 Prot, datë 15.12.2020 të Drejtorive Teknike, mbi miratimin e Programit të Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sha). Raporti vjetor hartohet në bazë të detyrave të Zyrtarit të Pajtueshmërisë, Z. Ervis Hazizi (Zyrtari), është miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikqyrës Nr. 9, date 02.06.2022, “Mbi miratimin e një ndryshimi në strukturën organizative të Shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes OSSH Sha dhe emeruar në datën 27.03.2023 nga Enti Rregullator i Energjisë.

Në lidhje me zbatimin e Programit të Pajtueshmërisë, ka synuar të prezantojë mekanizmin për zbatimin e këtij Programi, përcaktimin e detyrave funksionale dhe detyrimeve të punonjësve të OSSH Sha në lidhje me këtë program, duke u mbështetur në monitorimin dhe raportimin e zbatimit të këtij programi. Programi i Pajtueshmërisë përcakton detyrimet specifike të punonjësve për përmbushjen e këtij objekti dhe transponon në mënyrë të plotë kërkesat e Direktivës 2009/72/EC, në pajtim me Nenin 72 të Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike. Gjithashtu, programi përcakton të drejtat dhe detyrimet e Zyrtarit të Pajtueshmërisë për të raportuar çdo shkelje të dispozitave ligjore.

Ky raport vjetor hartohet për herë të dytë si pjesë e kompetencave ligjore të aktivitetit të Zyrtarit të shoqërisë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sha) në lidhje me zbatimin e Programit të Pajtueshmërisë. Në bazë të Programit të Pajtueshmërisë dhe kontratës që zotëron Zyrtari ka për detyrë hartimin e një raporti vjetor, ku përcaktohen masat e marra për zbatimin e Programit dhe dorëzimin e këtij raporti në ERE dhe tek Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

Shoqëria OSSH Sha është person juridik shqiptar, e krijuar nga aksionari i vetëm "OSHEE GROUP" SH.A., bazuar në nenin 3, pika 1, të ligjit 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), në formën ligjore të shoqërisë aksionare, me ofertë private, bazuar në nenin 103 të ligjit nr. 9901/2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, në korrespondencën dhe aktet e shoqërisë, përfshirë të gjitha shkresat, formularët e urdhërave, çdo publikim, të nxjerra nëpërmjet shkrimit apo formës elektronike që u adresohen palëve të treta, emri/emërtimi i Shoqërisë përmban të dhënat e mëposhme:

- a. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS): L81530018E;
- b. Emri i Subjektit: OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES;
- c. Data e themelimit: 28/03/2018;
- d. Formën ligjore të përshkruar me fjalë Shoqëri Aksionare ose Sh.A.;
- e. Selinë e saj; të dhëna nëse Shoqëria është në likuidim dhe vlera e kapitalit të regjistruar e shlyer;
- f. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri, TIRANË Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H. 1, Kati V, Njësia Administrative Nr. 7, 1023.

2. MODELI ADMINISTRATIV: “OPERATOR I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES”

2.1 Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë i Shoqërisë, i cili pa paragjykuar kompetencat e tjera të dhëna nga Ligji apo ky Statut, merr vendime për çështjet e mëposhtme të Shoqërisë:

- a) përcaktimi i politikave tregtare;
- b) miratimin e strategjisë dhe planeve financiare të Shoqërisë, si dhe të çdo ndryshimi të tyre;
- c) ndryshime të Statutit;
- ç) emërimi, si dhe shkarkimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit, nëse nuk përmbushin detyrimet e ngarkuara sipas ligjit dhe statutit;
- d) emërimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i ekspertëve kontabël të autorizuar;
- dh) miratimi i skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në pikat ç) dhe d);
- e) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve të ecurisë së veprimtarisë së Shoqërisë;
- ë) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- f) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
- g) pjesëtimin në pjesë të aksioneve dhe anulimin e tyre; ndryshime në të drejtat që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
- h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykime ndaj organeve administrative;
- i) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- j) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
- k) vendimet për investime;
- l) çështje të tjera në interes të saj ose sipas parashikimeve të këtij Statuti.
- ll) t’i propozojë Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë mëmë (kontrolluese) strukturë organizative, numrin e përgjithshëm të personelit të shoqërisë së kontrolluar SH.A., strukturën e pagave, nivelet e pagave dhe shtesa të tjera mbi pagë, kriteret për klasifikim sipas secilit nivel si dhe ndryshimet e tyre.

2.2 Këshilli i Administrimit OSSH

Anëtarët e Këshillit të Administrimit të Shoqërisë OSSH Sh.a.

Erald Hasanaj – Kryetar emëruar në datë 30.10.2023

Fatjola Halilaj – Anëtare emëruar në datë 30.10.2023

Bibjana Terolli – Anëtare emëruar në datë 30.10.2023

Mariglen Biti – Anëtar emëruar në datë 23.11.2021

Admirim Lakra – Anëtar emëruar në datë 11.07.2023

Këshilli i Administrimit të Shoqërisë së kontrolluar:

- 1) Përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë të cilët emërohen dhe shkarkohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme me shumicën e thjeshtë të aksionarëve, bazuar në tagrin e aksionarit të shoqërisë mëmë, bazuar në parashikimet e nenit 207/2 të ligjit nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.
- 2) Anëtarët e parë të Këshillit të Administrimit emërohen nga Asambleja me vendim të posaçëm.
- 3) Mandati i anëtarit të Këshillit të Administrimit zgjat 3 (tre) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.
- 4) Anëtar i Këshillit të Administrimit mund të zgjidhet çdo person sic parashikohet në nenin 156/1 të ligjit nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar apo individ që ka mbaruar arsimin e lartë, zotëron një diplomë të vlefshme në ekonomi, drejtësi, inxhinieri elektrike, menaxhim biznesi dhe që nuk preket nga kufizimet e parashikuara në nenin 156/2 të ligjit 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.
- 5) Kryetari i Këshillit të Administrimit kryeson mbledhjet dhe drejton punimet e mbledhjeve, nënshkruan korepondencën në emër të Këshillit, njofton Këshillin mbi ecurinë e çështjeve të Shoqërisë. Në mungesë të Kryetarit, kompetencat e tij kryhen nga Zëvendës Kryetari.
- 6) Anëtarët e Këshillit të Administrimit përfitojnë pagë bazë dhe shpërblime shtesë për pjesëmarrjen në Këshill.

Bazuar në nenin 163 të ligjit nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, në dispozitat e Statutit të shoqërisë OSSH SHA, dhe të Rregullores për funksionimin e brendshëm të Këshillit të Administrimit të shoqërisë, Këshilli i Administrimit të shoqërisë OSSH SH.A. për vitin 2023 ka zhvilluar 4 (katër) mbledhje në të cilat janë marrë 8 (tetë) vendime me karakter ekonomiko-financiar, plan investimesh etj.

Këshilli i Administrimit ka kompetencë:

- a) të japë direktiva për administratorin për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratori;
- c) të përgatisë me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
- ç) të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
- d) të kujdeset që Shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
- dh) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
- e) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga Administratori. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Administrimit për t'i paraqitur Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me një raport të Këshillit të Administrimit për miratim edhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë gjithë vitit financiar;
- ë) të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit auditues ligjor i autorizuar, i pavarur dhe raporti i auditimit, drejtuar Asamblesë së Përgjithshme, t'u vendoset në dispozicion të gjithë anëtarëve të Këshillit dhe Administratorit. Raporti i Këshillit të Administrimit, përmendur në pikën e), duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;
- f) t'i propozojë Asamblesë së Përgjithshme shkarkimin / lirimin e Administratorit;
- g) të përcaktojë shpërblimin e Administratorit;
- gj) të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 përqind të asetëve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare, të çertifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;
- h) të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;
- i) të miratojë ndryshimet nga plani i miratuar për furnizimin me mallra, shërbime apo shpenzime të tjera;
- j) të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj dhe në Statut;

Këshilli i Administrimit ka detyrimet e parashikuara në Statut dhe nenin 163 të ligjit nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.

2.3 Administratori

Administratori OSSH- Blendian Dalipi emëruar në datë 28.10.2022

1. Administratori emërohet nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë "OSHEE GROUP" SH.A. me propozim të Këshillit Mbikëqyrës të OSHEE GROUP SH.A. (shoqërisë mëmë) dhe e shkarkohet/lirohet nga Këshilli i Administrimit, me miratim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë. Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit është 3 (tre) vjet, me të drejtë rizgjedhje.
2. Administrator mund të zgjidhet çdo individ që ka mbaruar arsimin e lartë dhe që nuk preket nga kufizimet e parashikuara në nenin 13/1 dhe 158/2 të ligjit NT. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
3. Administratori ka këto kompetenca:
 - a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit te veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
 - b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç) të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilat ja paraqesin Këshillit të Administrimit për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga Asambleja e Përgjithshme;
 - d) të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;
 - dh) të raportojë përpara Këshillit të Administrimit për zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë;
 - e) të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në Statut;
 - f) Administratori është i detyruar të marrë miratim paraprak nga Asambleja e Përgjithshme dhe/ose Këshilli i Administrimit përpara marrjes dhe/ose zbatimit të ndonjë vendimi në lidhje me çështjet specifike të parashikuara në nenin 12.2 dhe nenin 16,1 h/i /j të këtij Statuti;
4. Detyrat që i cakton ligji e Statuti Këshillit të Administrimit, nuk mund të ushtrohen nga Administratori.
5. Administratori ka detyrimet e parashikuara në Statut, nenin 13 e vijues të ligjit Nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.

3. KUSH JEMI NE OSSH: “OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES”

3.1 Shpërndarja e energjisë elektrike

1. Shpërndarja e energjisë elektrike kryhet nga operatorë të sistemit të shpërndarjes, të cilët janë persona juridikë, të licencuar nga ERE sipas dispozitave të këtij ligji, Neni 68/ Ligj 43/2015.
2. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka në pronësi sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike në tension 35 kW, 06-20 kW, 04 kW, me qëllim lëvrimin e saj te klientët, ku kufiri i tij me sistemin e transmetimit është ai i përcaktuar në pikën 2, të nenit 54, të këtij ligji.
3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është përgjegjës për:
 - a) sigurimin e zhvillimit të sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemit të shpërndarjes;
 - b) përmbushjen e kërkesave për shpërndarjen e energjisë elektrike,
 - c) mirëmbajtjen dhe operimin e sigurt të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike në gjithë territorin për të cilin është licencuar.
 - d) ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar, të siguruar gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij;
 - e) prokuron energji elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me procedura transparente jodiskriminuese. Procedurat e prokurimit të energjisë elektrike miratohen nga ERE, pas propozimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes;
 - ë) i siguron pa pagesë dhe mbi bazën e një marrëveshjeje, çdo furnizuesi të energjisë elektrike, akses në të dhënat e matjes për klientët, me të cilët furnizuesi ka nënshkruar një kontratë furnizimi. ERE përcakton formatin e të dhënave dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj këtyre të dhënave;
4. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ofron pa diskriminim shërbimin e shpërndarjes së energjisë elektrike për të gjithë përdoruesit e rrjetit, që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet e tjera nënligjore. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes respekton treguesit e cilësisë së shërbimit dhe kërkesat e parashikuara nga rregulloret teknike.
5. Rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike zhvillohet mbi parimin e kostos më të ulët, në përputhje me legjislacionin mbi planifikimin urban, të drejtat e pronësisë, mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve dhe përdorimin me eficientë të energjisë.
6. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes instalon dhe përpunon të gjitha llojet e informacionit, komunikimeve dhe sistemeve teknologjike. Në varësi të mundësive, pjesë të infrastrukturës së komunikimeve dhe/ose kapaciteteve të rrjetit të komunikimit të shpejtësive të larta, mund të jepen në përdorim pa dëmtuar dhe rrezikuar veprimtaritë dhe rrjetet e veta brenda kuadrit të legjislacionit përkatës, në përputhje me opinionin e ERE-s.

3.2 Të drejtat e OSSH-së lidhur me burimet dytësore të energjisë

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sipas nenit 70 Ligj 43/2015 harton kushtet teknike, që miratohen nga ERE, për instalimin e një burimi dytësor të furnizimit me energji elektrike për klientët që kërkojnë këtë shërbim, përfshirë edhe kushtet që duhet të përmbushë burimi dytësor, me qëllim që të parandalohen çrregullimet në rrjet.
2. Çdo klient, që kërkon të instalojë burimin dytësor, dërgon paraprakisht një njoftim me shkrim pranë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe njëkohësisht u siguron përfaqësuesve të furnizuesit, me të cilin ka kontratë furnizimi, akses në burimin dytësor, me qëllim inspektimin e këtij instalimi.
3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka të drejtë të ndërpresë furnizimin me energji elektrike për një klient, në rast se nuk përmbush detyrimet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

3.3 Kodi i Shpërndarjes

- **Hartimi dhe miratimi i Kodit të ri të Shpërndarjes është objektiv për tu realizuar për vitin 2024.**

1. Kodi i Shpërndarjes sipas nenit 73 Ligj 43/2015 përcakton kërkesat teknike për planifikimin, zgjerimin, funksionimin, kontrollin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes dhe rregullat specifike për lidhjen dhe aksesin në rrjetin e shpërndarjes, si dhe rregullat e matjes.
2. Kodi i Shpërndarjes miratohet nga ERE, me propozim të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, i cili bashkëpunon me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë elektrike, me qëllim hartimin, rishikimin apo përshtatjen e tij.
3. Funksionimi i rrjetit të shpërndarjes duhet të jetë në përputhje me dispozitat e Kodit të Shpërndarjes.

3.4 Verifikimi i matësve

1. Verifikimi i matësve sipas nenit 77 Ligj 43/2015 të energjisë elektrike kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Meteorologjisë (DPM) ose nga një person juridik i autorizuar prej saj. Personi juridik i autorizuar për këtë qëllim akreditohet sipas legjislacionit në fuqi.
2. Aparatet matëse verifikohen përpara vënies në përdorim, nëpërmjet metodës së kampionit, në bazë të përzgjedhjes rastësore dhe në mënyrë periodike.
3. Verifikimi i matësve mund të realizohet me kërkesë të operatorit të sistemit. Verifikimi mund të realizohet në terren, aty ku matësi është i instaluar, pranë laboratorit të DPM-së apo personit juridik të autorizuar. Periodiciteti i verifikimit të matësve të instaluar te klienti përcaktohet në Kodin e Matjes. Në çdo rast duhet të jetë i pranishëm edhe përfaqësuesi i operatorit të sistemit.
4. Gjatë procesit të verifikimit të matësve të energjisë elektrike nga DPM-ja ose nga personi juridik i autorizuar, përfaqësuesi i operatorit të sistemit duhet të jetë i pranishëm në çdo rast. DPM-ja miraton

- procedurat përkatëse të verifikimit të matësve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare.
5. Kostot financiare për verifikimin përpara vënies në përdorim dhe verifikimin periodik të matësit apo verifikime të iniciuara nga operatori i sistemit përballohen nga ky i fundit. ERE merr në konsideratë këto kosto të shkaktuara operatorit, gjatë miratimit të tarifave përkatëse.
 6. Kur klienti dyshon në saktësinë e aparatit matës, paraqet një kërkesë me shkrim pranë operatorit të rrjetit, si dhe çdo institucioni tjetër përgjegjës për verifikimin e aparatit matës. Procedura për paraqitjen e një kërkesë, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit të kërkuarit miratohen me vendim të ERE-s. Kur verifikimi i matësit është bërë me kërkesë të klientit dhe gjatë verifikimit të matësit nuk konstatohen pasaktësi, shpenzimet e verifikimit paguhen nga klienti që ka paraqitur ankesën.
 7. Kur pas verifikimit konstatohen pasaktësi në matës dhe nuk ka prova të dëmtimeve me dashje, të bëra nga klienti, bëhen përlllogaritjet përkatëse të sasisë së energjisë së faturuar më shumë ose më pak, si rezultat i pasaktësisë në matës dhe mënyra e rimbursimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në Kodin e Matjes.
 8. Tarifat tavan për verifikimin e matësve miratohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe ministrit përgjegjës për energjinë.
 9. Operatori i sistemit nëse konstaton ndërhyrje të paligjshme, merr masa të menjëhershme për riparimin dhe zëvendësimin e pajisjeve, në të cilat është ndërhyrë, përlllogarit dëmin ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme dhe zbaton procedurat përkatëse sipas legjislacionit në fuqi. ERE miraton rregulloren dhe metodologjinë përkatëse për vendosjen dhe përlllogaritjen e dëmit ekonomik nga ana e operatorit të sistemit.
 10. ERE miraton kontratën tip ndërmjet operatorit të sistemit dhe DPM-së ose subjektit të autorizuar nga ana e saj për verifikimin e matësve.

4. PROGRAMI I PAJTUESHMERISË OSSH

Miratimin e Programit të Pajtueshmërisë së OSSH Sh.A.:

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 72, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE” miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 135/8 Prot, datë 15.12.2020 të Drejtorive Teknike, mbi miratimin e Programit të Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sha).

4.1. Dispozita të përgjithshme

Programi i Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSSH Sh.A.) përcakton kushtet për ndarjen dhe pavarësinë e OSSH Sh.A., në zbatim të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar.

Programi synon shmangien e sjelljeve diskriminuese të OSSH Sh.A. ndaj pjesëmarrësve të tjerë në tregun e energjisë elektrike, posaçërisht në favor të shoqërive bija, si dhe ofron mekanizmat për zbatimin, monitorimin dhe raportimin e tij. Programi përcakton detyrimet specifike të punonjësve për përmbushjen e këtij objekti dhe transponon në mënyrë të plotë kërkesat e Direktivës 2009/72/EC, në pajtim me Nenin 72 të Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike.

Programi i Pajtueshmërisë është miratuar me vendimin nr.18/2020 të Këshillit të Administrimit të OSSH Sh.A. Përmes komunikimit elektronik të datës 11 dhjetor 2020, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, përcolli në ERE komentet dhe sugjerimet e tij në lidhje me Programin e Pajtueshmërisë, të cilat siç u bëmë me dije nga ana e OSSH Sh.A., janë pasqyruar në pjesën më të madhe të tyre.

Në mënyrë të përmbledhur, komentet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë të cilat janë reflektuar në Programin e Pajtueshmërisë, konsistojnë në:

- a) Referimin më qartë të qëllimit të Programit për të shmangur sjelljen diskriminuese në favor të kompanive bija të OSSH Sh.A.;
- b) Vendosjen e një detyrë eksplicite ndaj Zyrtarit të Pajtueshmërisë sa i përket identifikimit të rasteve kur stafi është duke punuar njëkohësisht në më shumë se një kompani, apo është në konflikt (interesi);
- c) Të drejtën e aksesit të Zyrtarit në të gjithë të dhënat e rëndësishme të shoqërisë, të përfshihet në mënyrë të qartë në Program;
- ç) Nxjerrjen e rekomandimeve dhe udhëzimeve të brendshme nga ana e Zyrtarit;

Raporti i Pajtueshmërisë 2023 OSSH

- d) Punonjësit (e OSSH Sh.A.) jo vetëm të deklarojnë gatishmërinë për të implementuar Programin e Pajtueshmërisë, por ky i fundit duhet të jetë detyrues për ta;
- dh) Në të drejtat e punonjësve duhet të përfshihet e drejta për të adresuar tek Zyrtari çdo informacion lidhur me diskriminimin potencial, në mënyrë anonime;
- e) Përmbajtja e Programit Vjetor të përkufizohet më në detaje;
- ë) Aksesit në informacion dhe përjashtimi nga çdo privilegj (lidhur me informacionin) i kompanive bija në biznesin konkurrues duhet të adresohet në më shumë detaje;
- f) OSSH Sh.A., si një kompani me të drejtë ekskluzive duhet të prokurojë të gjithë mallrat dhe shërbimet përmes një procedurë konkurruese. Në rastet e ndonjë të mirë apo shërbimi të prokuruar brenda kompanisë, pa një procedurë publike prokurimi, këto të mira apo shërbime do të vlerësohen me çmim tregu ose në kosto, cilado (prej tyre) është më e ulët;
- g) Sa i përket sanksioneve disiplinore në nivelet menaxheriale dhe për të gjithë punonjësit e OSSH Sh.A., Programi i Pajtueshmërisë duhet të përfshijë pasoja shtesë/më të detajuara.

Në veçanti ky Program ka si qëllim të sigurojë:

- Ndarjen e duhur dhe pavarësinë e OSSH;
- Ndarjen e llogarive, menaxhimit, dhe vendimmarrje të plotë sipas ligjit 43/2015;
- Shmangien e sjelljeve diskriminuese të OSSH ndaj përdoruesve të rrjetit të shpërndarjes;
- Vendosjen e brendit të ri për të informuar publikun;
- Monitorimin dhe raportimin e zbatimit të këtij Programi në ERE;
- Përgatitja e raportit vjetor të detajuar.

4.2 Vlerësimet nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë për vitin 2023 për OSSH

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ka dhënë në mënyrë adekuate opinionin dhe vlerësimet e veta në lidhje me funksionimin e Shoqërisë OSSH për vitin 2023. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ka vlerësuar me 100% realizimin e një nder objektivet kryesor të OSSH/DSO UNBUNDLING ku ka deklaruar në raportin vjetor të mbajtur në datën 14.12.2023 në Vienë në Mbledhjen e Këshillit Ministror ku është cituar që Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është ligjërish i ndarë dhe funksional, ndarja u finalizua në periudhën raportuese. Në mars 2023, u miratua Zyrtari i Pajtueshmërisë. Raporti i Pajtueshmërisë për vitin 2022 i dorëzuar rregullatorit ERE dhe i publikuar në tetor 2023 në faqen zyrtare www.ere.gov.al.

Zyrtari i Pajtueshmërisë është personi kyç përgjegjës për monitorimin e përhershëm dhe të vazhdueshëm të zbatimit dhe efektivitetit të programit të pajtueshmërisë, për vlerësimin e efektivitetit të politikave, procedurave të aplikuara, masat dhe për raportim të rregullt tek autoriteti rregullator. Ky raport duhet të përmbajë shpjegimin e masave të marra dhe efektivitetin e tyre si dhe çdo rrezik për mospërputhje.

Raporti i Pajtueshmërisë 2023

OSSH

Për të përmbushur detyrën, Zyrtari duhet të jetë plotësisht i pavarur dhe duhet të ketë akses në të gjithë informacionin e nevojshëm, jo vetëm të OSSH-së, por të çdo filiali të ndërmarrjes. Shtrirja e Programit të Pajtueshmërisë do të varet nga kompleksiteti i ndërmarrjeve të integruara, formën e tyre ligjore dhe sistemin e menaxhimit dhe mbikëqyrjes tashmë të krijuar. Te shënimi *interpretues* shpjegon se Programi i Pajtueshmërisë do të përcaktojë masat e marra për të siguruar që të përjashtohet sjellja diskriminuese dhe të sigurohet që sjellja e stafit të OSSH-së në këtë aspekt të jetë monitoruar në mënyrë adekuate. Programi i Pajtueshmërisë do të përcaktojë në mënyrë eksplicite politikat dhe procedurat. Politika të tilla mund të përbëhen nga:

- mbështetje aktive, e rregullt dhe e dukshme e menaxhmentit për programin;
- angazhimi me shkrim i stafit ndaj programit duke u njohur dhe zbatuar Programin e Pajtueshmërisë;
- tregues për masat disiplinore që do të ndërmerren kundër stafit që shkel rregullat e programit;
- informim adekuat në lidhje me programin dhe trajnimin në Zyrat e OSSH Sh.A.

Konsulentët e huaj vlerësuan se Programi i Pajtueshmërisë OSSH është hartuar gjerësisht dhe mund të konsiderohet si një dokument gjithëpërfshirës që përcakton një detyrim për të mbikëqyrur pajtueshmërinë me ndarjen e kërkesave dhe raportimin për çdo mangësi. Sekretariati pajtohet me këtë program.

4.3 Emërimi i Zyrtarit të Pajtueshmërisë

Zyra e Zyrtarit të Pajtueshmërisë është miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikqyrës Nr. 9, date 02.06.2022, "Mbi miratimin e një ndryshimi në strukturën organizative të Shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes OSSH Sha Ervis Hazizi është emëruar nga ERE si Zyrtar Pajtueshmërie më datë 27.03.2023.

4.4 Detyrat e Zyrtarit të Pajtueshmërisë

Me Vendim të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë caktohet Zyrtari i Pajtueshmërisë, i cili është përgjegjës për të siguruar pajtueshmërinë, si dhe paraqitjen e Raportit të Pajtueshmërisë pranë ERE-s. Zyrtari i Pajtueshmërisë është përgjegjës për monitorimin lidhur me respektimin e detyrimeve ligjore të Programit të Pajtueshmërisë, si dhe për ndryshimet apo rishikimet e nevojshme të këtij programi me miratimin e ERE-s. Zyrtari i Pajtueshmërisë nuk do të mbajë, në mënyrë direkte apo indirekte, asnjë pozitë apo interes profesional në kompaninë vërtikalisht të integruar. Zyrtari i Pajtueshmërisë do të raportojë raste ku stafi i OSSH identifikohet të jetë punësuar në më shumë se një kompani në të njëjtën kohë, apo nëse stafi ka ndonjë konflikt tjetër interesi. Zyrtari i Pajtueshmërisë ka të drejtë të jetë i pranishëm në mbledhjet e Këshillit të Administrimit, apo të menaxhimit të OSSH Sh.A., kurdo që Zyrtari i Pajtueshmërisë, në diskrecionin e tij të plotë, vlerëson se pjesëmarrja e tij në mbledhje

kontribuon në ekzekutimin e detyrave të tij dhe mund të ndërlidhen me çështje të tilla si: kushtet e aksesit në sistemin e shpërndarjes, si dhe të përdorimit të këtij rrjeti, alokimin e kapaciteteve të shpërndarjes, transparenca, projektet në zbatim lidhur me operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, blerjen dhe shitjen e energjisë për nevoja të mbulimit të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, etj. Zyrtari i Pajtueshmërisë do të ketë qasje në të gjitha informatat që ai, në diskrecionin e tij, vendosë se janë të nevojshme për kryerjen e detyrave të tij, duke përfshirë të dhënat e OSSH-së dhe shoqërive bija. Zyrtari i Pajtueshmërisë raporton pranë Këshillit të Administrimit dhe stafit menaxherial të OSSH Sh.A., lidhur me mosmarrëveshjet e mundshme në kuadër të implementimit të Programit, si dhe përgatit me shkrim masat dhe propozimet për të rregulluar problematika të tilla, duke përfshirë këtu edhe rekomandime për udhëzime të brendshme. Në rast se këto problematika nuk janë rregulluar brenda një afati të arsyeshëm, Zyrtari i Pajtueshmërisë i raporton pranë ERE-s. Për shmangie të dyshimit, asgjë në këtë provizion nuk do të nënkuptojë që Zyrtari i Pajtueshmërisë është vartës ndaj Këshillit të Administrimit apo stafit menaxherial të OSSH Sh.A. Zyrtari i Pajtueshmërisë ka të drejtë, në diskrecionin e tij të plotë, të raportojë në mënyrë direkte pranë autoritetit rregullator për çdo shkelje të Programit të Pajtueshmërisë, përderisa e mban të informuar stafin menaxherial për këtë proces.

Metodologjia e kontrollit të Programit nga Zyrtari i Pajtueshmërisë OSSH Sh.A. do jetë e tillë:

- Mbledhja e informacionit në forma shkresore, e-mail-e duke patur akses te të dhënat e nevojshme dhe në zyrat e OSSH Sh.A.
- Verifikimi i dokumentacionit, i ankesave, i kontratave në mënyrë direkte apo indirekte.
- Marrja pjesë në të gjitha mbledhjet e drejtuesve të OSSH Sh.A. dhe organeve korporative, përfshirë Asambleenë e Përgjithshme, Këshillin Mbikqyrës dhe njësitë drejtuese.

5. NDARJA E AKTIVITETIT TË OSSH SH.A.

Pavarësia e shoqërisë “OSSH” Sh.A. e cila është sanksionuar në dispozitat e ligjit të sektorit të energjisë elektrike, reflektohet gjithashtu edhe në parashikimet statutoire të Statutit të shoqërisë. Konkretisht neni 25 i statutit të shoqërisë “OSSH” Sh.A. rregullon marrëdhëniet midis shoqërisë mëmë “OSHEE GROUP” Sh.A.

Në përputhje me ligjet dhe parashikimet statutoire gjatë periudhës 2020 e në vijim është kryer ndarja e aktivitetit të shoqërisë, e cila është realizuar ligjërisht nëpërmjet akteve administrative dhe nga ana funksionale nëpërmjet realizimit të aktivitetit të shoqërisë nga vetë strukturat në varësi të saj.

Me aktmarrëveshjen (kontratë kalimi e të drejtave reale) të datës 16.12.2020 të lidhur midis palëve shoqëria “OSHEE GROUP” Sh.A. dhe shoqëria “OSSH” Sh.A. është realizuar ndarja e shoqërisë “OSHEE” Sh.A. nëpërmjet transferimit të aktivitetit.

Raporti i Pajtuëshmërisë 2023

OSSH

Në momentin e bërjes efektive të ndarjes së shoqërisë, që nga viti 2020, dhe fitimit të plotë të personalitetit juridik shoqëria OSSH Sh.A. është drejtuar nga organet e veta vendimmarrëse, të cilat janë Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës.

Mbështetja e OSHEE GROUP Sh.A. është e kufizuar në funksione administrative dhe mbështetëse. Vendimet aktuale, operacionet e përditshme të OSSH Sh.A., si dhe çështjet e menaxhimit nuk do të ndikohen;

Asgjë në Marrëveshjen e Ofrimit të Shërbimeve nuk do të lexohet si përfundim, i drejtpërdrejtë ose indirekt, i të drejtave të vendimmarrjes ose të ushtrimit të ndikimit të OSHEE GROUP Sh.A., mbi OSSH Sh.A.

5.1 Ndarja ligjore

OSSH i plotëson kërkesat e programit pasi zhvillon aktivitetin e saj të ndarë nga aktivitetet e tjera që nuk kane lidhje me Furnizimi e Shpërdarjes Universale (FSHU) dhe Furnizimi I Tregut të Lire (FTL) dhe është në përputhje me Ligjit të nenit 16 dhe nenit 72, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, si dhe nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin*. Gjithashtu, OSSH është një person juridik i ndarë që është pjesë e kompanive vertikalisht të integruara OSHEE.GROUP.

Ndarja ligjore u përgatit në vitin 2019 dhe u krye menjëherë në fillim të vitit 2020 kur shoqëria filloi të funksionojë si një e vetme me të drejta të plota vendimmarrjeje në zbatim të ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”. Në fillim të vitit 2020 shoqëria aprovoi me vendim të veçantë “Programin e Pajtuëshmërisë”, i cili synon shmangien e sjelljeve diskriminuese të OSSH Sh.A. ndaj pjesëmarrësve të tjerë në tregun e energjisë elektrike, si dhe ofron mekanizmat për zbatimin, monitorimin dhe raportimin e tij. Zbatimi i këtij programi siguron që shoqëria:

- a) të ketë të drejta të plota vendimmarrëse, të pavarura nga shoqëria e integruar për të siguruar funksionimin, mirëmbajtjen apo zhvillimin e rrjetit të shpërdarjes.
- b) të hartojë dhe të depozitojë në organet kompetente një program vjetor të detajuar.

5.2 Ndarja funksionale

Ndarja funksionale lidhet me procesin e ndarjes së aseteve dhe detyrimeve nga shoqëria mëmë dhe sigurimin e përdorimit funksional të tyre, në shërbim të realizimit të objektivave të shoqërisë, i cili ishte një proces më i gjatë dhe më i ndërlikuar, që kërkoi shumë vendime organizative dhe kohë të implementimit. Veçanërisht ndarja e të drejtave dhe detyrimeve të shoqërisë sipas pasqyrës së bilancit, që u shoqërua me analiza të hollësishme të të dhënave të rregjistruara dhe të një metodologjie të veçantë të ndarjes, kërkoi një kohë më të madhe duke u shtrirë pothuajse gjatë gjithë vitit 2020.

Raporti i Pajtueshmërisë 2023

OSSH

Ky proces kishte të nevojshëm gjithashtu edhe ndryshime në skemën organizative të shoqërisë për të bërë të mundur rritjen e efikasitetit të menaxhimit dhe administrimit, për të theksuar që shoqëria është në transformim të vazhdueshëm dhe përshtatje më të mira funksionale janë objekt i vendimmarrjeve në vazhdim.

Vlerësimi i ndarjes nëpërmjet transferimit të aktivitetit të shoqërisë u krye nga Auditorët Ligjorë të Pavarur (I.L.D-99 Audit) sipas raportit të paraqitur në datën 10/12/2020.

5.3 Ndarja e menaxhmentit

Sipas Direktivës për Energjinë Elektrike, stafi drejtues i OSSH-së nuk mund të marrë pjesë në korporata, strukturat e VIU-së ose të ndonjë filiali të saj përgjegjës, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për ditën e përditshme funksionimin e prodhimit, shpërndarjes.

Në këtë drejtim, anëtarët e Bordit Drejtues, Drejtori i Përgjithshëm, si dhe Drejtorët Rajonal të OSSH-së nuk mund të punësohen nga kompania mëmë apo filialet e angazhuara në prodhim/prodhim dhe/ose furnizim dhe nuk mund të emërohen si anëtarët e çdo organi korporativ të këtyre kompanive, duke përfshirë mbikëqyrjen. Shënimi interpretues shpjegon se Drejtori i OSSH-së nuk mund të jetë në të njëjtën kohë një drejtor i kompanisë përkatëse të transmetimit, furnizimit ose prodhimit, ose anasjelltas, Programi i Pajtueshmërisë i OSSH-së përmban një dispozitë që personat që menaxhojnë OSSH-në “Nuk do të marrë kompensim financiar apo përfitim tjetër material apo financiar nga kompani të tjera dhe nuk do të ketë paga në lidhje me nivelin e performancës së kompanive të tjera në kuadër të kompani e integruar.

Ndërkohe unë si Zyrtar kam detyrë të verifikoj të gjitha rastet e sipërpërmenduar dhe nëse do të ketë ndonjë rast të tillë, do merren masa adekuate dhe do të raportohen në organet kompetente, siç e parashikon ligji.

5.4 Procesi i transferimit të punonjësve nga OSHEE ne OSSH

Në kuadër të procesit të ndarjes së Shoqërisë “OSHEE” sh.a. dhe të krijimit të shoqërive të reja, si një detyrim ligjor në kuadër të reformës në sektorin e energjisë dhe në zbatim të ligjit Nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”, si dhe të Urdhrit të Aksionerit të “OSHEE” sh.a. Nr. 157, datë 12.02.2018, mbi “Krijimin e tri shoqërive të kontrolluara nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, janë themeluar tri shoqëritë bija:

1. **Operatori i Sistemit të Shpërndarjes Sh.A (OSSH sh.a)** me ofertë private, me objekt aktiviteti shpërndarjen e energjisë elektrike, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për sigurimin e energjisë elektrike klientëve, lidhjen e

Raporti i Pajtuëshmërisë 2023

OSSH

klientëve dhe përdoruesve të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, instalimin dhe shërbimet e matjes së energjisë elektrike etj., si dhe çdo aktivitet tjetër fitimprurës me interes për shoqërinë;

2. **Furnizuesi i Shërbimit Universal Sh.A (FSHU sh.a)** me ofertë private, me objekt aktiviteti në furnizimin me energji elektrike të klienteve fundorë që veprojnë në treg të rregulluar të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, ofrimin dhe sigurimin e cilësisë tregtare të shërbimit, si dhe çdo aktivitet tjetër fitimprurës me interes për shoqërinë;
3. **Furnizuesi i Tregut të Lirë Sh.A, (FTL sh.a)** me ofertë private, me objekt aktiviteti në blerjen dhe menaxhimin e energjisë dhe operimin në tregun e lirë etj., si dhe çdo aktivitet tjetër fitimprurës me interes për shoqërinë.

Për rrjedhojë, në kuadër të bërjes efektive të ndarjes si dhe në zbatim të nenit 138 e vijues të Kodit të Punës, janë njoftuar të gjithë punonjësit se duke filluar nga data 01.01.2020 marrëdhëniet e tyre të punës transferohen nga punëdhënësi aktual "OSHEE" Sh.A. te punëdhënësi i ri "OSSH" Sh.A. me të njëjtat kushte kontraktore. Departamenti i Burimeve Njerëzore është ngarkuar për të ndjekur e për të njoftuar lidhur me vijimësinë e marrëdhënies së punës.

Në këtë aspekt, nga ana ime do të monitorohen të gjitha emërimet dhe transferimet nga stafi OSHEE në OSSH, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi dhe transparencën që ne do të ofrojmë me punonjësit.

Procedura e rekrutimit në OSSH Sh.a.

Rekrutimit i punonjësve të rinj në OSSH Sh.a. bëhet në zbatim të Manualit të Burimeve Njerëzore dhe Procedurës së Rekrutimit. Fillimi i procedurave të rekrutimit dhe selektimit për plotësimin e vendeve të lira të punës, miratohet nga Administratori i OSSH Sh.a. drejtuesi përkatës dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore që janë përgjegjës për realizimin e procedurave paraprake të rekrutimit si dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar dhe të përshtatshëm. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nëpërmjet përzgjedhjes në dosjen përkatëse të CV-ve të paraqitura dhe të depozituara pranë Burimeve Njerëzore.

Proçesi i punësimit realizohet nga një panel i veçantë, i përbërë minimalisht nga 3 persona, në të cilin detyrimisht marrin pjesë 2 përfaqësues të njësive organizative përkatëse ku do të punësohet punonjësi, si dhe një përfaqësues nga Departamenti i Burimeve Njerëzore

Numri mesatar i punonjësve për vitin 2023

Numri i punonjësve të Shoqërisë OSSH sh.a. gjatë vitit 2023 ka qenë 5503 e pasqyruar sipas tabelës së mëposhtme:

Raporti i Pajtuëshmërisë 2023

OSSH

Pershkrimi	Nr mesatar per njesi organizative
DREJTORIA E PERGJITHSHME	298
DREJTORIA RAJONALE TIRANE	1043
DREJTORIA RAJONALE DURRES	663
DREJTORIA RAJONALE BURREL	279
DREJTORIA RAJONALE SHKODER	396
DREJTORIA RAJONALE KUKES	153
DREJTORIA RAJONALE BERAT	297
DREJTORIA RAJONALE FIER	229
DREJTORIA RAJONALE ELBASAN	279
DREJTORIA RAJONALE KORÇE	253
DREJTORIA RAJONALE GJIROKASTER	240
DREJTORIA RAJONALE VLORE	242
NJESIA E TENSIONIT TE LARTE QENDER	221
NJESIA E TL JUG-PERENDIM	253
NJESIA E TL JUG-LINDJE	239
NJESIA E TL VERI	259
DREJTORIA E TENSIONIT TE LARTE	77
TASK FORCA	82

Mosha mesatare e punonjesve dhe ndarja sipas gjinise.

Viti 2023	Femra	Meshkuj
Numri mesatar	881	4461
Mosha mesatare	41.9	45.2

Arsimi i punonjesve te OSSH sh.a. gjate vitit 2023

Arsimi	Numri i punonjesve
Arsim i larte	1857
Arsim i mesem	3295
Arsim i detyrueshem	189

5.5 Organigrama

Në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet aktorëve kryesorë të Korporatës OSHEE, OSSH është ngritur Grup Pune për të ristrukturuar Strukturën e OSSH Sha në Dejtorinë Qëndrore dhe rajonale, është e nevojshme të bëhen drejtori të reja në Departamenti e Operimit të Rrjetit dhe Analizës se Performancës dhe Departamenti i Leximit, Menaxhimit të Matjes dhe Bilancit Energjitik;

- Drejtorja e Operimit të Rrjetit.
- Drejtorja e Analizës, përpunimit të të dhënave të cilësisë së rrjetit dhe monitorimit dhe zbatimit të kodeve dhe marrëdhënieve rregullatore.
- Drejtorja e Mbeshtetjes së Tregut të Energjisë.

Drejtorite që do të krijohen kanë sfida dhe vecori të vecanta kjo ka të bëjë me ndryshimet që janë kryer gjatë viteve të fundit në legjislacionin e miratuar dhe modelin e Tregut të Energjisë Elektrike për tu pershtatur me zhvillimet e reja sa i takon rinovimit dhe operimit të rrjetit shpërndares në përputhje me kërkesat që shtrohen nga hyrja e burimeve të reja të energjisë së rinovueshme (FV, Eolike, Biomase etj) dhe efekteve shoqeruesë të tyre në rrjetin shpërndares si dhe direktivave të Sekretariatit te Komunitetit të Energjisë;

- Drejtorja e Operimit të rrjetit TM-TU do të menaxhojë Rjetin Shpërndares TM 20/10/6/kV si dhe rrjetin shpërndarës TU_0.4 kV të njesive përkatëse duke mundësuar furnizimin optimal të përdoruesve, monitoron dhe raporton mbi operimin e furnizimit të objekteve të rëndësisë së vecantë si: Hidrovoret, Ujësjellesat, Spitalet etj. Harton një databasë të tyre dhe raporton problematikat në furnizimin e tyre.
- Drejtorja e Analizës do të përpunojë informacionin e ardhur nga Drejtorja TL dhe harton databasë e regjimit të ngarkesave të transformatoreve të fuqisë, linjave 35kV fdrave dalës dhe cilësisë së tensionit, reflekton ndryshimet e kryera në Kodin e Rrjetit dhe Kodin e Transmetimit dhe propozon ndryshimet e nevojshme në Kodin e Shpërndarjes, ndjek probematikat e tjera në lidhje me OST-ne dhe gjeneruesit e lidhur në rrjet ne zbatim të ligjeve dhe kodeve në fuqi.
- Drejtorja e Mbeshtetjes së Tregut të Energjisë do të ndjekë dhe zbatojë mbikqyrjen e procedurave të ndryshimeve të Furnizuesve për të gjithë konsumatorët që furnizohen në treg të lirë, krye raportime mujore për Shoqerinë OSSH Sh.a mbi shpërndarjen e energjisë sipas niveleve të tensionit, parashikimi i të gjitha ndryshimeve të tregut të energjisë dhe përshtatja e tyre në sisteme të automatizuara për lehtësimin e proceseve, ndjekja e marrëdhënieve me Entin Rregullator të Energjisë në lidhje me liberalizimin e tregut, pranimi i faturave dhe ndjekja e pagesave për shërbimet e kryera nga OSSH Sh.a dhe blerjet sipas nevojave.

6. PËRJASHTIMI I SJELLJES DISKRIMINUESE

Për të eliminuar sjelljen diskriminuuese ndaj përdoruesve të rrjetit të shpërndarjes, përfshirë konsumatorët dhe burimet e prodhimit të energjisë që janë lidhur në rrjetin elektrik të OSSH (Operatori i Sistemit të Shpërndarjes) zbaton disa rregulla dhe udhëzime si më poshtë:

- **Barazi në trajtim:** Siguron që të gjithë përdoruesit e rrjetit elektrik të OSSH, të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të drejtë, pa dallim përkatësisht në bazë të tipit të përdorimit të energjisë (konsumues, prodhues, etj.).
- **Tarifat e drejta dhe të barabarta:** Përcaktimi i tarifave dhe pagesave në një mënyrë që të jenë të drejta dhe të barabarta për të gjithë përdoruesit e rrjetit elektrik të OSSH, duke u bazuar në kostot e vërteta të shërbimeve të ofruara nga ana e saj.
- **Transparenca:** Siguron transparencë të plotë në procesin e përcaktimit të tarifave dhe politikave të tjera, duke përfshirë informacionin për metodat e llogaritjes së tarifave dhe kriteret e përdorura për të gjeneruar ato.
- **Konsultimi me përdoruesit:** Kryen konsultime të rregullta me përdoruesit e rrjetit elektrik të OSSH, për të adresuar çdo shqetësim ose nevojë të tyre dhe për të marrë feedback mbi politikën dhe rregulloret ekzistuese.
- **Mekanizmat e ankesave dhe korrigjimeve:** Përcakton mekanizma efikas për të trajtuar ankesat dhe kërkesat e përdoruesve nëse ata vërejnë diskriminim ose sjellje të pakëndshme në lidhje me shërbimet e ofruara nga OSSH /OSHEE sha Group (DSO)
- **Ndërtimi i marrëdhënieve të mirëfillta me konsumatorët dhe prodhuesit:** Përforcimi i marrëdhënieve me konsumatorët dhe prodhuesit e energjisë për të kuptuar më mirë nevojat e tyre dhe për të siguruar që shërbimet e ofruara nga OSSH për përdorimin e rrjetit elektrik të saj, janë në përputhje me kërkesat e tyre.
- **Mbikëqyrja e përdorimit të rrjetit:** Monitorimi i vazhdueshëm i përdorimit të rrjetit elektrik të OSSH nga përdoruesit e energjisë elektrike për të identifikuar shenjat e mundshme të diskriminimit dhe për të ndërhyrë nëse është e nevojshme për të korrigjuar sjelljet e padrejta.

Raporti i Pajtueshmërisë 2023

OSSH

Gjithashtu, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) në tregun e energjisë elektrike operon për të siguruar një qasje jo-diskriminuese për të gjithë përdoruesit e rrjetit të tij. Disa mënyra se si OSSH mund të sigurojë këtë qasje janë:

- **Rregullime të qarta dhe të përshtatshme:** OSSH ka rregulla dhe procedura të qarta dhe të drejtpërdrejta për
 - lidhjet e reja,
 - përfitimet e rrjetit,
 - çdo shërbim tjetër që ofrohet për përdoruesit e tij.

Këto rregulla janë transparente dhe të njohura për të gjithë përdoruesit potencialë dhe të ekzistues të rrjetit.

- **Përfaqësimi i përdoruesve:** OSSH ka mekanizma për të dëgjuar dhe përfaqësuar interesat e të gjithë përdoruesve të rrjetit të tij, duke përfshirë konsumatorët, prodhuesit e energjisë së rinovueshme, operatorët e tregut, dhe të tjerë.
- **Pavarësia dhe transparencja:** OSSH operon në mënyrë të pavarur nga interesat e tij komerciale dhe është transparent në veprimet dhe vendimet e tij. Kjo përfshin publikimin e informacionit mbi performancën e rrjetit, rregulloret, dhe tarifat në një mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për të gjithë.
- **Procese të barabarta për lidhjet dhe shërbimet:** OSSH zbaton procese të barabarta dhe të drejta për lidhjet e reja dhe për shërbimet e tjera të rrjetit për të siguruar që të gjithë përdoruesit të trajtohen me drejtësi dhe pa diskriminim.
- **Monitorimi dhe mbikqyrja:** OSSH ka mekanizma për të monitoruar dhe mbikqyrur veprimtarinë e tij për të siguruar përmbushjen e kërkesave për qasje jo-diskriminuese për të gjithë përdoruesit e rrjetit.

Përmes këtyre veprimeve dhe përkushtimit të OSSH së për t'u përputhur me kërkesat dhe parimet e qasjes jo-diskriminuese, sigurohet që rrjeti i energjisë elektrike ofrohet në një mënyrë të drejtë dhe të barabartë për të gjithë përdoruesit.

7. KONKURRENCA DHE MARRËDHENIET KOMERCIALE

Në Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (DSO), konkurrenca dhe marrëdhëniet komerciale mund të kenë disa aspekte të veçanta duke pasur parasysh karakteristikat e sektorit të energjisë elektrike dhe kontekstin ligjor në të cilin operon OSSH. Këtu janë disa aspekte të konkurrencës dhe marrëdhënieve komerciale në OSSH:

- **Konkurrenca në tregun e lidhjeve:** Në disa juridiksione, OSSH sikurse është vendi yne mund të jetë i vetmi operator i rrjetit të shpërndarjes dhe klientët e tij janë të detyruar të lidhen me të për shërbimet e rrjetit. Megjithatë, në disa vende, ka mundësi për operatorë të tjerë të rrjetit të ofrojnë shërbime konkurruese për lidhje dhe të konkurojnë me OSSH-në.
- **Marrëdhëniet me përdoruesit e rrjetit:** OSSH është në marrëdhënie komerciale me klientët e tij, duke ofruar shërbime të ndryshme të rrjetit, duke përfshirë lidhjet e reja, shërbimet e mirëmbajtjes, dhe të tjera. Këto marrëdhënie rregullohen nga rregulloret të ndryshme vendore dhe mund të përfshijnë tarifa të ndryshme dhe kushte kontratash.
- **Marrëdhëniet me operatorët e tregut:** OSSH ka marrëdhënie me operatorët e tregut të energjisë elektrike, duke përfshirë operatorët e tregut të energjisë dhe furnizuesit e energjisë. Këto marrëdhënie mund të përfshijnë bashkëpunim për menaxhimin e ngarkesave, shkëmbimin e informacionit për planifikimin e kapacitetit, dhe të tjera.
- **Blerja e energjisë:** Në disa raste, OSSH mund të jetë përgjegjës për blerjen e energjisë për të siguruar që kërkesat e rrjetit të përputhen me ofertat e disponueshme të prodhuesve të energjisë. Ky proces mund të përfshijë tenderime publike dhe marrëveshje me operatorë të tregut të energjisë.
- **Marrëdhëniet me autoritetet rregullatore:** OSSH është në marrëdhënie me autoritetet rregullatore të energjisë elektrike, të cilat kanë përgjegjësi për mbikqyrjen dhe rregullimin e tregut të energjisë. Këto marrëdhënie janë të rëndësishme për të siguruar përputhjen me rregulloret dhe për të zgjidhur çështje të ndryshme ligjore dhe të rregullatoreve. Në përgjithësi, në OSSH, konkurrenca dhe marrëdhëniet komerciale janë të rëndësishme për funksionimin e qëndrueshëm dhe efikas të sektorit të energjisë elektrike, duke siguruar që shërbimet e rrjetit ofrohen në një mënyrë të drejtë dhe efektive për të gjithë përdoruesit e rrjetit.

Rregullat dhe kriteret për të parandaluar kufizimet ose ndikimin në konkurrencën e drejtë në tregun e energjisë elektrike për të siguruar një qasje jo-diskriminuese në marrëdhëniet komerciale përfshijnë:

- **Transparenca e informacionit:** OSSH siguron informacion në lidhje me proceset e shpërndarjes së energjisë dhe kërkesat teknike të jenë të qarta dhe të aksesueshme për të gjithë operatorët:
 - Publikimi i informacionit
 - Raportimi i performancës
 - Aksesueshmëria e dokumentacionit dhe të dhënave
 - Konsultimi me operatorët e tjerë
 - Auditime dhe monitorim i pavarur
- **Kufizimi i konfliktit të interesit:** Në rastet kur një punonjës ose drejtues i OSSH-së ka një konflikt të interesit të vërtetë ose të dukshëm, ndalohej pjesëmarrja e tyre në proceset vendimmarrëse që mund të prekin interesat e tyre të personave ose entiteteve të tjera;
 - Politikat e deklaratës së konfliktit të interesit
 - Ndalimi i pjesëmarrjes në vendime
- **Pavarësia e vendimmarrjes:** OSSH ka një pavarësi për vendimmarrjes brenda OSSH -së për të siguruar që vendimet janë të bazuar në kriteret dhe nevojat e tregut dhe konsumatorëve, dhe jo në interesat e individëve të veçantë (KB, Grupe pune monitoruese etj)
- **Procedurat e hapura dhe të përcaktuara për qasje në rrjet:** OSSH ka procedura të përcaktuara dhe të njohura për operatorët që kërkojnë qasje në rrjet, pa diskriminim në favor të ndonjë operatori;
 - Koha dhe procesi i aplikimit
 - Aplikimi i kriterëve në mënyrë të barabartë
 - Monitorimi i pavarur
- **Rregullimi i çmimit dhe i tarifave:** OSSH siguron mekanizma për monitorimin e çmimeve dhe tarifave të aplikuar nga OSSH për të siguruar që ato janë të drejta dhe të drejtpërdrejta për të gjithë operatorët.
- **Monitorimi dhe raportimi i ndarjes së monopolit dhe aktiviteteve të tjera të OSSH:** ERE monitoron veprimtarinë e OSSH dhe raporton për ndonjë shkelje potenciale të rregullave të konkurrencës ose të drejtat e operatorëve të tjerë sic janë
 - Raportime financiare
 - Auditime dhe verifikime periodike
 - Trasparenca e proceseve vendimmarrëse
 - Monitorim i pavarur
- **Ndarja e funksioneve:** Për të parandaluar konfliktet e interesit, për të siguruar konkurrencën e drejtë në treg, operatori i rrjetit elektrik realizon
 - Ndarjen e Qartë të Përgjegjesive
 - Transparenca dhe llogaridhënia

8. ZBATIMET E TRASPARENCËS, PAANSHMËRISË TË TRAJMIN E ANKESAVE PËR PËRDORUESIT E RRJETIT

Parimet e transparencës dhe të paanshëmërisë në veprimtarinë e një Operatori të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSSH) janë të rëndësishme për sigurimin e qeverisjes së mirë korporative dhe për të mbrojtur interesat e përdoruesve të rrjetit elektrik të saj. Disa prej tyre janë:

- **Publikimi i informacionit:** Sigurimi që informacioni i rëndësishëm për operacionet, performancën, tarifën dhe politikën e OSSH-së publikohet dhe është i qasshëm për të gjithë grupet e interesit.
- **Proceset e vendimmarrjes transparente:** Zbatimi i proceseve transparente dhe i qartë për vendimmarrjen OSSH sh a, duke përfshirë procedurat për hartimin e politikave, përcaktimin e tarifave dhe zbatimin e investimeve pjese perberese te strategjise se kompanise te miratuara ne Mater Planin e saj si shoqeri ne perputhje me;
 - Ligjet dhe rregullat në fuqi të vendit tonë
 - Strategjinë Kombëtare të vendit
 - Direktivave të EU/27
- **Konsultime publike:** Organizimi i konsultimeve publike dhe sesioneve informuese për të diskutuar politikën dhe vendimet e rëndësishme që ndikojnë në përdoruesit e rrjetit elektrik të OSSH
- **Ndarja e informacionit të rëndësishëm:** Sigurimi që informacioni i ndryshëm për performancën e rrjetit, shërbimet, dhe tarifën ndahet në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme.
- **Monitorimi i Pavarur:** Përdorimi i mekanizmave të pavarura për monitorimin dhe vlerësimin e performancës së OSSH-së në përputhje me standardet dhe kërkesat e ERE dhe Operatorit të tregut të Energjisë.
- **Mekanizma të ankesave:** Sigurimi i mekanizmave të drejtë dhe transparent për trajtimin e ankesave dhe përgjigjen ndaj çdo shqetësimi të përdoruesve të rrjetit elektrik të OSSH.
- **Ndërgjegjësimi dhe edukimi:** Ndërgjegjësimi i përdoruesve dhe dhe grupeve te Interesit në lidhje me të drejtat e tyre dhe mekanizmat për të monitoruar dhe raportuar ndonjë sjellje të pakëndshme ose të paanshme nga OSSH.
- Këto parime dhe praktika të transparencës dhe të paanshëmërisë ndihmojnë në rritjen e besimit publik ndaj OSSH-së dhe në promovimin e një mjedisi të hapur dhe të përgjegjshëm për të gjithë përdoruesit e rrjetit elektrik të saj.

Në lidhje me zbatimin e proceduarave të trajtimit të ankesave, kërkesave, transparencës, procedurat që ndiqen nga Drejtoria e Ofritmit të Rrjetit, lidhjet e reja trajtohen sipas RREGULLORES PËR LIDHJET E REJA NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES Miratuar me Vendimin Nr.166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, e ndryshuar me Vendimin Nr.177, datë 08.11.2016 të Bordit të ERE ku:

- OSSH sha siguron lidhjen në rrjetin e shpërndarjes për të gjithë palët e interesuara në përputhje me ligjin Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe me kriteret e përcaktuara në këtë Rregullore.
- Lidhjet e reja apo modifikimet e lidhjes ekzistuese nuk shkaktojnë efekte negative mbi klientët apo përdoruesit ekzistues gjithashtu as në rrjetin shpërndarës të OSSH, duke respektuar standardin ISO 18001.
- Aplikimi për lidhjen e re bëhet pranë zyrës së Kujdesit të Klientit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në zonën e vendndodhjes së objektit dhe tarifat për lidhjet e reja janë të njëjta për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, janë përcaktuar në përputhje me objektivat e mëposhtme: mosdiskriminim, transparencë që lidhet me përdorimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe pjesëve integrale të tij, zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes, në mënyrë që të sigurohet rruajtja e nivelit të cilësisë së furnizimit me energji elektrike.
- Realizimi i Lidhjes së Re realizohet brenda afateve të përcaktuara në Rregulloren e Lidhjeve të Reja,
 - Afati i realizimit të Lidhjes së re në TU është 20 ditë pune.
 - Afati i realizimit të Lidhjes së re në TM është 60 ditë pune.

Ka dhe raste kur kalon afati kohor dhe nuk janë realizuar praktikrat kjo për arsye të ndryshme të cilat janë;

- Mosprezenca e abonentit në objekt, gjatë azhornimit teknik.
- Pagesa që kryhet nga abonentit.

- Kohëzgjatje e kryerjes së përfundimit të punimeve nga abonentit (përfundimi i objektit shtrirja e linjes, instalimet e brëndshme).

9. E DREJTA E INFORMIMIT DHE INOVACIONI

Publikimi i informacionit të rëndësishëm për performancën, tarifat dhe politikat e një Operatori të Sistemit të Shpërndarjes sikurse është OSSH për grupet e interesit mund të realizohet nëpërmjet disa mënyrave të ndryshme të komunikimit dhe transparencës. Disa prej tyre janë:

- **Faqja zyrtare e internetit:** Ka një faqe zyrtare në internet dhe website që është një mjet i rëndësishëm për publikimin e informacionit të rëndësishëm ku OSSH mund të publikojë raporte vjetore, informacione për tarifat, politikat dhe procedurat e shërbimeve, dhe të dhëna për performancën e rrjetit elektrik te saj.
- **Raportet vjetore:** OSSH-ja harton dhe publikon raporte vjetore të performancës së saj, të cilat përfshijnë informacionin për sigurinë e rrjetit, shërbimet e ofruara, investimet, dhe zhvillimet e tjera të rëndësishme.
- **Konsultime publike:** Organizimi i konsultimeve publike dhe sesioneve informuese për të diskutuar politikat e reja, tarifat dhe çdo ndryshim tjetër që ka ndikim në përdoruesit e rrjetit elektrik.

Raporti i Pajtuëshmërisë 2023

OSSH

- **Njoftimet dhe komunikimi direkt:** OSSH-ja bën njoftime dhe komunikime direkte me përdoruesit e rrjetit elektrik përmes e-mail-it, letrave informative, ose mesazheve në faqen e saj në internet.
- **Raportimi në media dhe lajmet:** Informacioni i rëndësishëm për performancën, tarifat dhe politikën e OSSH-së raporton në media lokale dhe në lajmet e rrjeteve sociale për të arritur një audiencë më të gjerë.
- **Qendra e shërbimeve dhe ndihma për përdoruesit:** OSSH siguron i një qender të shërbimeve dhe ndihmë për konsumatorët dhe prodhuesit për të përgjigjur pyetje dhe për të ofruar ndihmë në lidhje me informacionin dhe politikën e OSSH-së.
- **Forume dhe takime lokale:** Organizimi i forumeve dhe takimeve lokale për të diskutuar çështjet e rëndësishme me përdoruesit e rrjetit elektrik të OSSH se dhe për të dëgjuar shqetësimet dhe sugjerimet e tyre.

Këto mënyra të publikimit të informacionit janë të rëndësishme për të siguruar transparencë nga OSSH dhe për të siguruar që përdoruesit e rrjetit elektrik kanë akses të nevojshëm për të gjitha informacionet relevante.

Nga monitorimi i website-it të ri zyrtar të OSSH, ne vijim të rekomandimeve të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë të lëna në raportin e vitit 2022, vërehet se website-i i OSSH është ri-dizenjuar me kushtet bashkëkohore duke përmirësuar mënyrën e dhenies dhe organizimit të informacionit të duhur sipas fushave të caktuara që operon, duke bërë një prezantim më të mirë, menaxhimin e duhur të informacionit të rëndësishëm si dhe pajtuëshmërinë me standardet e sigurisë që aplikohen për sistemet e informacionit në WEB.

Në bashkëpunim me stafin drejtues, janë implementuar :

- Vendosja e brendit të ri dhe Website më fleksibel, që sot ne kemi plotësuar këtë kusht dhe operojmë si gjithë Kompanit e tjera në treg.
- Vendosjen e një rubrike të re, e cila quhet **Njofto/Raporto të Zyrtari** ku është e lidhur automatikisht me adresën time të email dhe do trajtohen rastet në mënyrë konfidenciale në lidhje me aktivitetin e shoqërisë OSSH.Sha; kjo është realizuar në kohë.
- Zyrtat që i perkasin Operatori i Sistemit të Shpërndarjes janë me logon OSSH;

INOVACIONI

Gjithashtu dua të theksoj dhe risitë inovative në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet OSHEE dhe OSSH ku do të lançojë një portal të ri e të aksesueshëm për të gjithë klientët, me qëllim marrjen e shërbimeve *online* në formën më të shpejtë e më praktike të mundshme. Është zgjeruar gama e shërbimeve që do të ofrohen *online*, pa qenë nevoja të humbasësh kohë në sportelet e Kujdesit ndaj Klientit; vendim ky që e përafuron OSHEE-në me standardet bashkëkohore.

“Lidhja e re” ose ofrimi i shërbimit të lidhjes së kontratës me OSHEE/OSSH do të ofrohet *online* në portalin www.oshee.al dhe www.ossh.al. Ky është njëri nga shërbimet më të kontestuara nga klientët tanë, për shkak të praktikave që çonin në zvarritje dhe humbje kohe, për të mos thënë edhe kosto ekonomike, prandaj OSHEE e vendosi në fokus të reformës së derregullimit.

Në faqen e re të internetit abonenti mund të ndjekë hap pas hapi të gjithë procesin e aplikimit për shërbimin e kërkuar, në cilën fazë ndodhet, deri në marrjen e përgjigjes/shërbimit. Mjafton të futësh kodin dhe mund ta gjurmosh çështjen përmes platformës online, për të cilën kemi punuar deri në detaj, që klientët ta kenë sa më të thjeshtë përdorimin.

Përmes celularit mund të shkarkosh jo vetëm faturat, por mund të marrësh shërbime të ndryshme;

- Menaxhimi i kontratave qe zoteron perdoruesi
- Gjenerimi ne menyre automatike i vertetimit të debise
- Pagesa e faturave të energjisë elektrike online
- Përdoruesi shikon historikun e kosumit të energjisë elektrike
- Përdoruesi sheh historikun e pagesave të energjisë elektrike
- Cdo kërkesë / ankesë menaxhohet dhe bëhet online si:

1. Ankesë për faturim

- Kryqezim matesi
- Tarifim i gabuar
- Ankesë për Tv Tax
- Ekzekutim Vendim Gjykate
- Kërkesë për rimbursim / disbursim
- Faturim pas pezullimi / terminimi

2. Ndryshimi i të dhënave të kontratës

- Saktësim i të dhënave të kontratës

- Ndryshim Emri (Familjar)
- Ndryshim Emri (Jo Familjar)
- Ndryshim i përdoruesit të pronës
- Heqje e përdoruesit të pronës
- Reaktivizime të kontratave
- Pezullime të kontratës
- Mbyllje përfundimtare të kontratës
- Rilidhje Shërbimi pas pezullimit të procesit të përmbarimit

3. Ankesa për Pagesa Kreditime

- Moskreditim nga Posta Shqiptare
- Kreditim Pagese (Bank)
- Kreditim Pagese (Arka OSHEE)
- Kreditim Pagese (MM)
- Ekzekutim Vendim Gjykatë
- Kërkesë për kthim shume (pagesë e gabuar)

4. Cilësi Shërbimi

- Defekt i kabinës
- Defekt i rrjetit
- Defekt në shtyllë
- Vjedhje e aseteve të kompanisë
- Ankese për vjedhje të energjisë
- Ankese për cilësinë e energjisë
- Ankese për ndërprerje të paplanifikuar të energjisë
- Ankesë për vonesa në shërbime
- Ankesë për sjelljen e punonjësve
- Kërkesë për dëmshpërblim që rrjedhin nga cilësia e furnizimit me energji
- Kërkesë për dëmshpërblim që rrjedhin nga dëmet e luhatjes së tensionit
- Kërkesë për dëmshpërblim që rrjedhin nga vonesat në kthim përgjigje të shërbimeve

5. Ankesa lidhur me matesin

- Defekt në automat
 - Defekt në sistemin e matjes
 - Zëvendësim matësi
 - Spostim matësi
 - Rilidhje Sherbimi si rezultat i nderprerjes
- Informacion i detajuar mbi kontraten
 - Lista e të gjithë kërkesave / ankesave
 - Kërkesë për lidhje të re

10. RUAJTJA E KONFIDENCIALITETIT TË INFORMACIONEVE TË NDJESHME

Stafi i shoqërisë OSSH ka marrë të gjitha masat që materialet që kanë informacion të ndjeshëm tregëtar sic jane (dokumentat, arkivues të të dhënave elektronike, kompjutera, mobiread, tableta, telefonat etj.) të mbrohen në bazë të protokolleve në fuqi, kontrates kolektive dhe kodit të sjelljes. OSSH gjithashtu nuk shpërndan informacionin e ndjeshëm tregëtar tek ndonjë pale e tretë, përveç rasteve kur: Shpërndarja e informacionit kërkohet shprehimisht nga ligji, duke siguruar që kjo shpërndarje të kryhet sipas një mënyre të percaktuar me ligj. Drejtuesit dhe punonjësit e OSSH sigurojnë konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregëtar të cilët e kanë në dispozicion për shkak të detyrës profesionale. Të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e OSSH, përfaqësuesit e autorizuar, audituesit dhe këshillëtarët nuk shpërdajnë ose kanë shpërndarë informacion të ndjeshëm tregëtar tek ndonjë pale e tretë gjatë emërimit të tyre ose bashkëpunimit me OSSH.

Për më tepër informacioni konfidencial mund të përfshijë ndër të tjera:

- Kushtet financiare dhe teknike të aksesit në rrjet (kontratat individuale të aksesit në rrjet);
- Kushtet financiare dhe të tjera të furnizimit me energji
- Të dhënat matëse, profilet e ngarkesës së konsumatorëve
- Lidhje të reja joaktive dhe të planifikuara në rrjet
- Detajet e kontaktit të klientit, të dhënat e faturimit, të dhënat bankare, etj.

11. OFRIMI I SHËRBIMEVE TË PËRBASHKËTA

Shërbimet e përbashkëta që ofrohen nga Shoqëria "OSHEE GROUP" SH.A., në zbatim të Marrëveshjes për Ofrimin e Shërbimeve me nr. 13531 datë 29.12.2023, Nr. 9891 datë 26.12.2023, me afat 2 vjeçar i cili zgjatet me pëlqimin e palëve, gjatë gjithë kësaj periudhe, në përputhje me objektin e ri të liçensuar të aktivitetit OSHEE ka nënshkruar kontratën e shërbimit me OSSH. Efektet e kësaj marrëveshje hyjnë në fuqi me vlefshmëri prej datës 1 Janar 2024.

Planifikimi i shpenzimeve për shërbime korporative është bazuar tërësisht në kontratën e lidhur ndërmjet OSSH dhe OSHEE Grup për ofrimin e këtyre shërbimeve. Shpenzimet e faturuar dhe ato të planifikuara janë bazuar tërësisht në parimin e sanksiomuar në rregullat e përgjithshme dhe parimet bazë të metodologjisë së llogaritjes së çmimeve të aprovuar nga palët sipas të cilit:

"Çmimi i Shërbimeve duhet të sigurojnë të ardhura të nevojshme për mbulimin e shpenzimeve të arsyeshme për shoqërinë e shërbimit. Të ardhurat e kërkuara për mbulimin e shpenzimeve të shërbimeve janë baza e llogaritjes së Çmimeve të Shërbimeve."

a. Shpenzimet për shërbime korporative

Përqëndrimi i shërbimeve të grupit në një shoqëri të veçantë brënda grupit ka si qëllim ofrimin e specializuar të këtyre shërbimeve duke rritur cilësinë dhe performancën e shpenzimeve nëpërmjet specializimit të ngushtë duke shfrytëzuar me efikasitet burimet njerëzore dhe informacionet historike që shoqëria OSHEE (si shoqëri mëmë) ka trashëguar.

Ky përqëndrim mundëson uljen e shpenzimeve për njësi të shërbimeve të cilat do të ishin shumë më të mëdha nëse do të organizoheshin drejtpërdrejt nga shoqëritë e ndara (bija).

Në përputhje me marrëveshjen e re të licencuar, OSHEE ka nënshkruar një kontratë shërbimi me OSSH për shërbimet e mëposhtme:

- Shërbime të Burimeve Njerëzore
- Shërbime Ligjore
- Shërbime të Informacionit dhe Inovacionit
- Shërbime Mbështetëse
- Shërbime IT
- Shërbimet Ekonomike
- Shërbime të Përmiresimit të Performacës
- Shërbime të projekteve me financim të huaj
- Shërbime të Sigurisë Kibernetike

Kosto e shërbimeve korporative, bazuar në kontratat e lidhura, për vitin në vazhdim llogaritet bazuar në planin financiar të shoqërisë për çdo shërbim dhe faturohet për çdo muaj bazuar mbi këtë përlllogaritje,

ndërsa vlerësimi përfundimtar vjetor i çmimit të shërbimit bëhet brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës dhe faturohet diferenca.

Kryerja e shërbimeve të përqëndruara nuk ka si qëllim krijimin e fitimit të shoqërisë por ka si qëllim krijimin e rezervave ligjore dhe të domosdoshme, si dhe investime në rritje të efikasitetit të shërbimeve të ofruara.

b. Metoda e llogaritjes së kostos së shërbimeve korporative

Metoda e llogaritjes së shërbimeve korporative kalon në 2 faza kryesore:

a) Llogaritja e kostos totale të shërbimit

Struktura organizative e OSHEE është ndërtuar duke u bazuar në shërbimet e ofruara dhe përbëhet nga:

- Administrimi i Përgjithshëm (Këshilli Mbikqyrës, Auditim, Njësi zbatim projektësh)
- Departamenti Informacionit dhe Inovacionit
- Departamenti i Përmiresimit të Performacës
- Departamenti e Burimeve Njerëzore
- Departamenti Ligjore
- Departamenti Shërbimeve Mbështetëse
- Departamenti Teknologjisë së Informacionit
- Departamenti Ekonomik
- Departamenti Sigurisë Kibernetike

Kostot e shërbimeve korporative në shoqërinë OSHEE evidentohen sipas qendrave të kostos bazuar në përbërjen e strukturës organizative të shoqërisë mbi të cilat është ndërtuar edhe evidentimi i kostove në programin financiar SAP.

Pasi merren të dhënat vjetore të evidentuara të kostove sipas secilës nga qendrat e kostos në sistemin SAP bëhet shpërndarja e shpenzimeve të përgjithshme të shoqërisë e cila përfshihet në qendrën e parë të kostos sipas listimit më sipër bazuar në peshën specifike të kostove vjetore të njësive të tjera ndaj totalit të kostos.

Bazuar në kontratën e shërbimit llogaritet edhe kosto e kapitalit të shoqërisë dhe shpërndahet me të njëjtën metodë të peshës specifike të llogaritur.

b) Shpërndarja e kostos së shërbimit për shoqëritë e grupit.

Shpërndarja e kostove të shërbimeve të OSHEE sh.a. për shoqëritë bija bazohet në raportet e shpërndarjes të cilët janë specifike për secilin lloj shërbimi. Llogaritja e shpërndarjes së kostove bazohen në parimet e mëposhtme:

- Duhet të jenë transparente dhe lehtësisht të kuptueshëm;
- Duhet të jenë të matshëm;

- Duhet të pasqyrojnë në masën më të madhe të mundshme një përfaqësim të saktë të përkatësisë së kostove.
- Ata nuk do të ndër-subvencionojnë në mënyrë të padrejtë kostot midis shoqërive bija dhe do të sigurojnë veçanërisht që kostot që u përkasin shoqërive konkurruese të Grupit, nuk do të alokohen OSSH SH.A. -së.

12. ALOKIMI KOSTOS NË OSSH

Në Operator Sistemi Shpërndarjes (OSSH), kostot alokohen në mënyra të ndryshme në përputhje me praktikën e ndryshme të industrisë dhe rregulloret vendore.

Disa mënyra të zakonshme për alokimin e kostove në OSSH janë:

- **Kostot operative:** Kostot operative përfshijnë shpenzimet e përditshme për operacionin e rrjetit të shpërndarjes, siç janë shpenzimet për mirëmbajtje, menaxhimin e energjisë, zbatimin e rregullores, pagesat e punëtorëve, dhe të tjera. Këto koste janë të shpërndara në të gjithë rrjetin në mënyrë proporcionale me përdorimin e rrjetit.
- **Kostot e investimeve:** Kostot e investimeve përfshijnë shpenzimet për ndërtimin e infrastrukturës së re dhe për modernizimin e rrjetit. Këto koste mund të alokohen në baza të ndryshme, siç janë numri i klientëve, përdorimi i rrjetit, ose sipas rregullores vendore.
- **Kostot e financimit:** Kostot e financimit përfshijnë shpenzimet për interesat e borxhit dhe të financimit të kapitalit të nevojshëm për operacionet dhe investimet e rrjetit. Këto koste janë të shpërndara në të gjithë rrjetin bazuar në strukturën e financimit të OSSH-së.
- **Kostot e zbatimit të rregullores:** Kostot e zbatimit të rregullores përfshijnë shpenzimet për përputhjen me rregullat dhe standardet e vendosura nga organet e rregullimit. Këto koste janë të përfshira në tarifën që paguajnë përdoruesit e rrjetit.
- **Kostot e humbjeve të energjisë:** Kostot e humbjeve të energjisë përfshijnë shpenzimet për humbjet fizike të energjisë gjatë transmetimit dhe shpërndarjes së saj në rrjet. Këto koste janë të shpërndara në bazë të formës së humbjes dhe të rregullores vendore.
- OSSH përdor një kombinim të këtyre metodave për të siguruar një alokim të drejtë dhe efikas të kostove në rrjetin e tij, duke marrë parasysh nevojat e përdoruesve të rrjetit dhe rregullores të vendit.
- Është e rëndësishme që alokimet e kostove të janë transparente dhe të kontrollueshme për të gjithë përdoruesit e rrjetit dhe organet e rregullimit.

13. ZBATIMI I PROGRAMIT TË PAJTUESHMËRISË

Dispozitat e këtij Programi janë të detyrueshme për të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e OSSH. Programi është detyrues për përfaqësuesit e autorizuar të OSSH, për audituesit, këshilltarët, kontraktuesit, pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit, si dhe palët e tjera të treta.

Të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e OSSH, përfaqësuesit e autorizuar, audituesit, kanë konfirmuar me shkrim që janë të informuar dhe do ta zbatojnë Programin. Ata janë informuar nga Zyrtari i Pajtuëshmërisë me e-mail. Për çdo shkelje të dispozitave të Programit, drejtuesit ose punonjësit e OSSH informojnë menjëherë Zyrtarin e Pajtuëshmërisë. Në rast të konstatimit, shkelja e ndonjë dispozite të Programit i jap OSSH të drejtën për të aplikuar procedurën disiplinore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ne këtë aspekt më duhet të theksoj që unë si Zyrtar Pajtuëshmërie sapo kam marë detyren kam informuar stafin OSSH për tu njohur me programin dhe që ky është një detyrim ligjor për ta zbatuar të gjithë. Gjithashtu në kuadër të njohjes së programit kam marë konfirmim me shkrim nga punonjësit që janë njohur me programin. Ndërkohë jam në proces të zhvillimit të trajnimeve në lidhje me programin dhe informacion adekuat dhe transparent për punonjësit e rrinj që janë bashkuar dhe do të bashkohen në vazhdimësi në OSSH.

Për të siguruar zbatimin e plotë të këtij Programi, Zyrtari i Pajtuëshmërisë është i obliguar për:

- Hartimin e Raportit Vjetor lidhur me zbatimin e Programit;
- Propozimin e masave për përmirësimin e Programit;
- Përditësimin e Programimit;
- Hulumtim i dokumentacionit të vënë në dispozicion (të tilla si vendime, kontrata, rregullore, relacione etj);
- Raportin mbi implementimin dhe monitorimin e Programit, përputhshmërinë e akteve dhe proceseve të brendshme të shoqërisë me Programin e Pajtuëshmërisë

Me miratimin e këtij Programi nga Enti Rregullator i Energjisë, OSSH Sh.a. do të informojë të gjithë punonjësit për t'iu përmbajtur parimeve të përcaktuara në Program.

Zyrtari i Pajtuëshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes paraqet çdo vit në ERE një raport vjetor, i cili përcakton masat e marra në kuadër të programit të pajtuëshmërisë. Zyrtari i Pajtuëshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes është plotësisht i pavarur dhe ka akses në të gjitha informacionet e nevojshme të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe çdo shoqërie të lidhur, për të përmbushur detyrën e tij.

14. HUMBJET TOTALE NË RRJETIN E SHPËRNDARJES PËR VITIN 2023

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes OSSH Sha është përgjegjës për sigurimin e zhvillimit të sigurtë dhe të qëndrueshëm të sistemit të shpërndarjes, përmbushjen e kërkesave për shpërndarjen e energjisë elektrike, si mirëmbajtjen dhe operimin e sigurt të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike në të gjithë territorin për të cilin është licencuar.

Humbjet totale në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike përfaqësojnë humbjet teknike në rrjet dhe humbjet joteknike.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes OSSH Sha është organizuar në 11 zona shpërndarjeje dhe 42 agjenci. Efektiviteti i shitjes së energjisë elektrike vazhdon në vlera të rritura, duke iu referuar gjithnjë faktorëve përcaktues në nivelin e eficiencës së konsumit të energjisë elektrike.

Bordi i EREs me vendim Nr. 324, Datë 14.12.2022, i cili ka lene ne fuqi vendimin Nr. 73, Datë 13.04.2022, deri aplikimin e OSSH për ndryshimin e tarifave ekzistuese, vendosi miratimin e tarifave të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit, për periudhën 1 Maj – 31 Dhjetor 2022, si vijon:

Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV - 1.55 Lekë/Kwh;

Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 0.6 - 20 kV - 3.99 Lekë/Kwh;

Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV - 6.42 Lekë/Kwh;

Miratimin e çmimit të aplikueshëm për faturimin e energjisë reaktive për periudhën 1 Maj – 31 Dhjetor 2022 prej 1.92 lekë/kVArh.

Per sa i përket cmimeve mund të themi se Shoqëria OSSH.Sha është në përputhje me këto cmime dhe operon sipas vendimit të ERE.

Sikurse evidentohet më poshte, humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes përgjatë vitit 2023 janë në nivelin 18.93%, kundrejt objektivit 19.0%, pra me nje ulje prej -0.07% mbi targetin e vendosur në VKM nr. 758, datë 09.12.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr. 253, datë 24.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik, elektroenergjitik”.

Humbjet e përgjithshme në sistemin e shpërndarjes për vitin 2022, arrijnë në masën 19.72%.

Viti 2023 rezulton me një ulje të nivelit të humbjeve prej -0.79% krahasuar me vitin 2022.

Viti 2023 krahasuar me vitin paraardhes 2022 rezultatet janë si më poshte:




Fig 1 Humbjet totale, teknike dhe joteknike (%)

14.1 Treguesit e Bilancit Energjistik

Bazuar në ligjin "Për Sektorin e Energjisë" dhe Modelin e Tregut të Energjisë të miratuar, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka për detyrë të sigurojë energji me qëllim të përmbush kërkësat e konsumatorëve që përfitojnë nga Shërbimi Universal i Furnizimit dhe nga Furnizuesit e tjerë të licënsuar.

Bilanci Energjistik për vitet 2019 – 2023

Raporti i Pajtueshmërisë 2023 OSSH


Përshkrimi		Progresive 2019	Progresive 2020	Progresive 2021	Progresive 2022	Progresive 2023
Energjia e injektuar nga OST ne rrjetin e OSSH	T	6,137,250	6,184,178	6,606,381	6,545,568	6,491,776
Energji elektrike e injektuar ne OST nga Hec-et ne rrjetin e OSSH	T.1	229,380	180,053	415,433	354,379	516,517
Energji e transmetuar per OSSH - Bilanc NET	T.2=T-T.1	5,907,870	6,004,125	6,190,949	6,191,189	5,975,259
Energji e transmetuar nga OSSH	T.3=T.2+P	6,576,432	6,605,083	7,136,936	7,046,021	7,061,769
Prodhimi I injektuar ne OSSH nga BREE-t	P = a + b + c = d	668,561	600,958	945,988	854,831	1,086,510
Prodhimi nga HEC-et e mesem	a	33,368	28,643	27,504	25,423	23,244
Prodhimi nga HEC-et private, koncesionet dhe Imp.te tjere	b	612,997	540,050	877,727	777,899	982,392
Energjia e injektuar nga Imp. Fotovoltaike dhe te tjere	c	22,196	32,265	40,756	50,092	58,430
Prodhimi i injektuar ne OSSH nga BREE-t ne Treg te Parregulluar	d	-	-	-	1,417	22,444
Energjia Totale ne rrjetin e OSSH	3 = T+P	6,805,811	6,785,136	7,552,369	7,400,399	7,578,286
Energji Totale e perdorur ne OSSH	4=S/1+12+13+14	5,322,850	5,327,396	5,995,416	5,941,143	6,144,012
Humbjet totale ne rrjetin e OSSH	5 = 6+8	1,482,962	1,457,740	1,556,953	1,459,257	1,434,274
Humbjet totale ne rrjetin e OSSH (%)	5 / 3	21.79%	21.48%	20.62%	19.72%	18.93%
Humbjet teknike ne njesite TL	6 = 3 -(7+11)	117,739	103,729	107,340	94,747	98,166
Humbjet teknike ne njesite TL (%)	6 / 3	1.73%	1.53%	1.42%	1.28%	1.30%
Energji per Zonat e OSSH	7	6,684,100	6,677,351	7,440,731	7,301,298	7,475,669
Humbjet ne zonat e OSSH	8=7-(S+T.1+12+13)	1,365,222	1,354,012	1,449,613	1,364,509	1,336,107
Humbje ne zonat e OSSH (%)	8 / 7	20.42%	20.28%	19.48%	18.69%	17.87%
Humbjet Teknike	9	836,561	828,906	921,330	886,682	892,334
Humbjet Teknike (%)	9 / 3	12.52%	12.41%	12.38%	12.14%	11.94%
Humbjet Jo Teknike	10= 8-9	528,661	525,106	528,283	477,828	443,774
Humbjet Jo Teknike (%)	10 / 3	7.77%	7.74%	6.99%	6.46%	5.86%
Energji e Shitur per klientet e FSHU Sh.a	S	5,048,288	5,044,888	5,464,100	5,506,588	5,567,539
Energji e shitur nga FSHU (konsumi vetjak te Njesive te TL te OSSH)	11	3,972	4,056	4,298	4,354	4,451
Energji e Totale Shitur nga FSHU Sh.a	S/1=S+11	5,052,261	5,048,944	5,468,398	5,510,942	5,571,990
Energji per klientet e dal ne treg te parregulluar	12	41,209	67,126	82,829	50,607	44,306
Demi Ekonomik (aplikimi vendimit te ERE 232/2019)	13	-	31,272	28,756	25,215	11,200
Energji e injektuar ne OST nga Hec-et ne rrjetin e OSSH	14=T.1	229,380	180,053	415,433	354,379	516,517

Tab 2 Përshkrimi i bilancit total energjitik për rrjetin e shpërndarjes

Humbjet totale ndër vite në rrjetin e shpërndarjes:

VITI	Energji e IN (MWh)	Energji Out (MWh)	Humbjet (MWh)	Humbjet (%)
2013	7,146,571	3,925,920	3,220,651	45.07%
2014	6,935,244	4,313,304	2,621,940	37.81%
2015	6,494,867	4,459,242	2,035,625	31.34%
2016	6,399,716	4,605,263	1,794,454	28.04%
2017	6,498,515	4,781,998	1,716,517	26.41%
2018	6,436,970	4,883,784	1,538,503	23.90%
2019	6,805,811	5,322,850	1,482,962	21.79%
2020	6,785,136	5,327,396	1,457,740	21.48%
2021	7,552,369	5,995,416	1,556,953	20.62%
2022	7,400,399	5,941,143	1,459,257	19.72%
2023	7,578,286	6,144,012	1,434,274	18.93%

Raporti i Pajtueshmërisë 2023 OSSH



Ka një ecuri në ulje të humbjeve në % nga viti në vit. Kundrejt vitit 2013 Humbjet janë reduktuar me afro 1,786 GWh ose rreth -26.1%. Humbjet janë ulur në vlerë absolute (MWh) krahasuar me të gjithë vitet paraardhese duke arritur deri në reduktimin me afro 55.5%, ulje krahasuar me vitin 2013.

Sic është parashtruar edhe me lart ka një ecuri në ulje të energjisë së humbur pavarësisht së energjia e qarkulluar në rrjetin e shpërndarjes në 3 vitet e fundit ka shënuar rritje të konsiderueshme kundrejt të gjithë viteve të mëparshëm.

Në tabelën e mëposhtme jepen humbjet për vitin 2023 në mënyrë të detajuar sipas:

- Drejtorive Rajonale
- Nivelit të tensionit TL, TM & TU
- Konsumi Vetjak ne TL
- Nivel rrjeti OSSH.Sh.a

Rajonet Shperndarese	Humbjet Totale (Janar - Dhjetor) 2023			
	Blerja e Energjise MWh	Faturimi MWh	Humbjet MWh	Humbje %
Tirane	2,528,530	2,210,136	318,394	12.59%
Durres	966,224	786,060	180,164	18.65%
Fier	459,211	399,164	60,047	13.08%
Elbasan	518,939	444,443	74,496	14.36%
Korce	409,800	354,572	55,228	13.48%
Gjirokaster	313,297	256,590	56,707	18.10%
Shkoder	705,988	469,421	236,567	33.51%
Berat	442,459	372,813	69,646	15.74%
Kukes	230,715	137,499	93,215	40.40%
Burrel	528,365	405,583	122,782	23.24%
Vlore	372,143	303,281	68,861	18.50%
Humbjet ne TM&TU	7,475,669	6,139,561	1,336,107	17.87%
Humbjet teknike ne TL	98,166	-	98,166	1.30%
Konsumi vetjak Njesive te TL	4,451	4,451	-	-
Humbjet Total OSSH.Sh.a. Viti 2023	7,578,286	6,144,012	1,434,274	18.93%

Raporti i Pajtueshmërisë 2023

OSSH

Sic evidentohet nga tabela më poshte, kontributin më të madh në reduktimin e humbjeve e ka dhene ulja e tyre në segmentin TM&TU (pasi aty qarkullon rreth 98% e Energjisë totale në rrjet) përgjate 12 mujorit të vitit 2023 ndaj vitit 2022.

Humbjet	Viti 2022	Viti 2023	Reduktimi Humbjeve
TM&TU	18.69%	17.87%	-0.82%
Tension Larte	1.28%	1.30%	0.02%
Total OSSH. Sh.a	19.72%	18.93%	-0.79%

Objektivi mbi Humbjet në rrjetin e Shperndarjes për vitin 2024 është 18.5% sipas VKM Nr. 758, date 9.12.201 “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 253, date 24.4.2019, te Këshillit te Ministrave, “Për miratimin e Planit të Konsolidimit Financiar të Sektorit Publik, Elektroenergjetik”.

VKM përmendur përcakton/parashikon projeksionin vjetor të mëposhtëm mbi humbjet në rrjetin e shpërndarjes dhe mbledhjem e të ardhurave për OSHEE Group për periudhen në vazhdim deri në vitin 2026.

VENDIM Nr. 758, datë 9.12.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 253, DATË 24.4.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PLANIT TË KONSOLIDIMIT FINANCIAR TË SEKTORIT PUBLIK, ELEKTROENERGJETIK”

	Humbjet totale (%)	Mbledhja e të ardhurave (%)
2014	37.8	91.9
2015	31.3	98.3
2016	28.0	92.0
2017	26.4	97.0
2018	23.9	95.0
2019	21.8	95.0
2020	21.5	95.0
2021	20.5	95.0
2022	19.6	95.0
2023	19.0	
2024	18.5	
2025	18.1	
2026	17.8	

Tabela e mësipërme tregon një motivim më shumë për të berë një progres të jashtëzakonshëm në këtë Drejtori, ku synohen ulje të ndjeshme të niveleve të humbjeve duke pasur parasysh kohën e pandemisë që nuk janë zhvilluar mjaftueshëm investime në rrjetin e shpërndarjes për të minimizuar humbjet, falë bashkëpunimit të OSSH me të gjithë strukturat përkatëse për të arritur një rezultat pozitiv.

15. OPERIMI I RRJETIT

Departamenti i Operimit të Rrjetit dhe Analizës së Difekteve kryen funksionin e vet bazuar në Kodin e Shpërndarjes, Neni 3 Kapitulli Operimi, Vendimit ERE nr.181, date 10.11.2017 “Rregullore për kriteret standarte të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performances për sigurinë e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”

- Në funksion të saj ka si detyrë operimin e sigurtë të Sistemit të Shpërndarjes, koordinimin dhe bashkëveprimin me Operatorin e Sistemit Transmetimit OST Sha, Prodhuesit e Energjisë Elektrike, N/stacionet në administrim të OSSH-se, Dispeceritë TM/ TU.
- Gjithashtu mbledh, rregjistron dhe përpunon të dhënat në lidhje me standartet e cilësisë së furnizimit dhe performancës së rrjetit shpërndarjes dhe raporton të dhënat e cdo 3 –muajori në ERE si dhe merr pjesë në procesin e Monitorimit të të dhënave në rastin e inicimit të këtij procesi nga ERE.

Këto procese pune realizohen ndërmjet 5 (pese) sektoreve, si më poshtë:

- Sektori i Operimit dhe Mirëmbajtjes së Rrjetit TL dhe NST
- Dispeceria TL
- Sektori i Operimit dhe Mirëmbajtjes së Rrjetit në TM/TU
- Sektori i Përpunimit të të Dhenave dhe Regjimit të Punës
- Sektori i Operimit të HEC-eve

Gjatë vitit 2023 janë realizuar detyrat sipas funksioneve përkatëse të secilit sektor si mëposhte:

- **Sektori i Operimit dhe Mirëmbajtjes së Rrjetit TL / NST dhe Dispeceria TL**

Dispeceria e Tensionit të Lartë dhe sektori i mirëmbajtjes së rrjetit, ka realizuar menaxhimin operativ të sistemit të Shpërndarjes në rang vendi me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë së sistemit të shpërndarjes.

Nepërmjet trajnimit dhe instruksionit të personelit është arritur qëndrueshmëria e sistemit për kthimin sa më të shpejtë të energjisë elektrike tek konsumatorët, është bërë në mënyrë korrekte rregjistrimin e të gjitha ndërprjeve të rrjetit TL/Nst nëpër librat operativ. Mbi bazën e këtyre rregjistrimeve është bërë dhe kalimi i tyre nëpër tabelat përkatëse në exel sipas formatimeve përkatëse.

Ka monitoruar dhe menaxhuar ngarkesat maksimale në raste ekstreme ose ngjarjeve të vecanta, gjatë fillimit të vitit 2023, sezonit veror 2023 dhe gadishmërive të ndryshme gjatë gjithë vitit 2023, vecanërisht gjatë periudhës me kushte të keqja atmosferike. Për cdo ngjarje janë marrë masa nëpërmjet planeve për gadishmëri në sigurimin me energji të pandërprerë të konsumtorëve.

Është bërë e mundur evidentimi i pikave kritike të rrjetit shpërndarës dhe adresimi i tyre në departamentet përkatëse.

Ka kryer në mënyrë korrekte të gjitha udhezimet e marra nga dispeceria e OST-se, bazuar në kodet e shpërndarjes, të transmetimit si dhe kodit të etikës, duke ndikuar pozitivisht në qëndrueshmërinë e sistemit elektroenergjitik shqiptar, vecanërisht në situatat e veshtira të prodhimit të lartë të Hece-ve në vend.

Është zbatuar me korrektesë grumbullimi, përpunimi dhe mbikëqyrja për zbatimin e planit grafik të remonteve, si për sistemin e transmetimit OST dhe planit të DTL-se, duke bërë dhe rakordimet për të minimizuar stakimet për remonet.

Është realizuar në mënyrë të saktë skema e njoftimit duke zbatuar dhe afatet zyrtare të vendosura nga ERE, për të gjitha ndërprerjet e planifikuara dhe të paplanifikuara me zyrën e shtypit, subjekteve private dhe departamenteve të tjera.

Janë evidentuar të gjitha pikat e dobëta në nënstacione dhe linja 35 kV mbi të cilat duhet të investohet apo të bëhen remonte të thella në vitin në vijim.

Janë zbatuar të gjitha afatet ligjore për kthim përgjigjet e shkresave adresuar këtij sektori.

➤ **Spektori i Operimit dhe Mirëmbajtjes së Rrjetit në TM/TU**

Spektori i operimit dhe mirëmbajtjes së Rrjetit TM/TU ka realizuar me sukses grumbullimin dhe raportimin në kohe reale të stakimeve të rrjetit TM/TU gjatë gjithë vitit 2023 dhe vecanërisht gjatë gatishmërive në rastet e përkeqesimit të kushteve atmosferike, të mbingarkesave për shkak të temperaturave të uleta, si dhe të gatishmërive të ngritura për shkak të aktiviteteve të ndryshme në rang vendi.

Falë insistimit dhe këmbënguljes të vazhdueshme, u arrit të disiplinohet dhe të vijojë procesi i grumbullimit dhe menaxhimit të remonteve në rrjetin TM/TU për të gjitha drejtorite rajonale.

Është realizuar procesi i grumbullimit të stakimeve nga të gjitha drejtorite rajonale dhe përpunimi i tyre sipas formularëve përkatës.

Janë evidentuar të gjitha pikat e dobëta në linjat TM kryesisht ajrore dhe kabina shpërndarëse mbi të cilat duhet të investohet apo të bëhen remonte të thella në vitin në vijim.

Janë zbatuar të gjitha afatet ligjore për kthim përgjigjet të shkresave adresuar këtij sektori.

➤ **Spektori i Përpunimit të të Dhenave dhe Regjimit të Punës**

Nga ky sektor është realizuar në mënyrë korrekte grumbullimi dhe përpunimi i stakimeve të rrjetit shpërndarës TL/TM/TU.

Është realizuar përlllogaritja e Treguesve të Cilësisë së Furnizimit të Energjisë Elektrike dhe Performancës së Rrjetit sipas Niveleve të Tensionit TL/ TM/ TU për çdo muaj dhe në mënyrë progresive 3-mujore, 6-mujore, 9-mujore dhe përformanën Vjetore 2023. Tregues këto të përcaktuara me Vendim të ERE nr 181 datë 10.11.2017 “Rregullore për kriteret standarte të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike” dhe Vendim nr 97 date 07.04.2021 “Mbi miratimin e Treguesve për kriteret, standartet e cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes për vitin 2021”. Këto tregues konsistojnë në: SAIDI (kohëzgjatja e stakimeve për konsumator), SAIFI (frekuenca e ndërprerjeve për konsumator), Koha e

Raporti i Pajtuëshmërisë 2023

OSSH

riparimit të difektit, Niveli i frekuencës, Niveli i Tensionit dhe Energjia e Pa Furnizuar. (Tabela e mëposhtëme)

PERIUDHA Janar- Dhjetor 2022-2023						
Emërtimi i rrjetit	SAIFI		SAIDI		Ndryshimi në % SAIDI	Ndryshimi në % SAIFI
	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2022	Viti 2023		
Total TL	7.00	7.89	11.46	11.87	-3.6%	-13%
Total TM	22.11	21.60	40.97	36.70	10.4%	2%
Total TU	2.06	1.37	2.26	1.61	28.9%	33%
Total OSSH	31.16	30.86	54.68	50.18	8.2%	1.0%

Është realizuar përlogaritja e parshikimit të treguesve të performancës që duhet të arrihen bazuar në planin e investimeve dhe të mirëmbajtjes sipas tabelës së mëposhtme.

Emërtimi	Përmirësimi në % SAIF-It	Përmirësimi në % SAID- it
Rrjeti TL- N/st	0.8%	0.8%
Ndërtim Rrjeti TM	1.8%	1.6%
Rikonstrukcion Rrjeti TM/TU	1.0%	0.9%
Investime prioritare (Rrjet TU - ABC lines)	3.1%	4.7%
Total OSSH 2024	4.4%	3.1%

Janë zbatuar të gjitha afatet ligjore për kthim përgjigjet e shkresave adresuar këtij sektori. Nga treguesit e cilësisë së furnizimit më sipër rezulton që investimet e OSSH duhet të përqendrohen kryesisht në TM dhe TU për të mundësuar përmirësim të ndjeshëm të tyre në vijim.

➤ Sektori i Operimit të HEC-eve

Nga ky sektor është realizuar në menyrë korrekte ndërtimi dhe përditesimi i databasë të gjeneruesve të lidhur në sistemin e shpërndarjes në bashkepunim me Departamentin e Menaxhimit të Rrjetit. Janë zbatuar të gjitha afatet ligjore për kthim përgjigjet të shkresave për ankesat e gjeneruesve në lidhje me stakimet, bashkëndimi me DTL, Dispecerine TL dhe Dispecerine TM/ TU. Është realizuar përpunimi i dokumentacionit teknik të punonjesve të OST, Prodhuesve, Konsumatorëve në TL, DTL-se, drejtorive rajonale në zbatim të Kodit të Shpërndarjes, Rregullores së Shfrytëzimit dhe Sigurimit Teknik dhe proces procedurave përkatëse.

Sektori i menaxhimit të Sistemit SCADA

Modulet kryesore që na ofron ky system janë:

1. (DE – Data Engineering): Moduli i menaxhimit të database.
2. (UI – User Interface): Moduli i ndërfaqes operative të sistemit.

3. (FES – Front End System): Moduli i ndërfaqes së sistemit qendror me sistemet lokale (periferike).
4. (SCADA Applications – Supervisory, Control and Data Acquisition): moduli i funksioneve të monitorimit, kontrollit të të dhënave të rrjetit.
5. (HIS – Historical Information System): moduli i menaxhimit të të dhënave historike të rrjetit.
6. (TNA – Transmission Network Analysis): llogaritja e të dhënave dhe analiza e kontigjencës referuar kriterit (n-1).
7. (FA – Forecast Applications); moduli i parashikimit të të dhënave të ngarkesës ose të prodhimit të burimeve të rinovueshme.

Të gjitha këto module janë tepër të rëndësishme për një funksionim të sigurt, të qendrueshëm dhe eficient të sistemit të shpërndarjes.

Nisur nga sa më sipër detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të këtij sektori janë:

- Koordinon aktivitetet e Dispecerimit dhe menaxhimit të rrjetit shpërndarës nëpërmjet përdorimit të Sistemit SCADA
- Furnizim të shkallës së kërkuar të sigurisë të sistemeve SCADA
- Integrim me sistemet e tjera dhe proceset e biznesit
- Zhvillim, planifikim, ndërtim dhe mirëmbajtje e Sistemit Rele dhe Sistemit Lokal Automatik
- Koordinimi i sistemit të mbrojtjes përmes zhvillimit të planeve të vendosjes së pajisjeve mbrojtëse, harmonizimit të planeve të vendosjes së pajisjeve mbrojtëse me nivelin superior dhe përdoruesit e rrjetit, përcaktimi i kushteve për përdoruesit e rrjetit, si dhe rishikimi i raportit për vendosjen e pajisjes mbrojtëse.
- Menaxhimi i sistemeve rezervë
- Analize e ngjarjeve operative dhe propozim për masa përmirësuese
- Përditesimi i të dhënave në rast implementimi pikash matjeje të reja. Integrimi i elementeve të rinj në nënstacione ekzistuese apo edhe integrimi i një nënstacioni të ri i cili do të monitorohet dhe kontrollohet në SCADA.
- Testimi i komunikimit ndërmjet sistemit qendror dhe sistemeve periferike për matjet e reja të sapo implementuara.
- Menaxhimi i sistemit për optimizimin e performancës së rrjetit. Pjesë e aplikacioneve të sistemit SCADA është qendrueshmëria dhe optimizimi i rrjetit nëpërmjet parashikimeve apo studimit të historikut të ngarkesave.

Përfshirja në sistem e burimeve hidrike apo fotovoltaike janë pjesë e analizimit dhe optimizimit të rrjetit

Gjatë vitit 2023 janë mbajtur komunikimet shkresore dhe realizuar takime me ERE-n, për problematika të ndryshme në lidhje me furnizimin me energji elektrike të gjithë përdoruesve të rrjetit.

Janë realizuar takime dhe korrespondenca shkresore me OST-ne, për problematika të ndryshme në lidhje me furnizimin me energji elektrike të gjithë përdoruesve të rrjetit kryesisht në periudha gatishmërie.

Raporti i Pajtueshmërisë 2023

OSSH

Janë realizuar takime dhe korrespondenca me departamentet e tjera të OSSH-së, OSHEE-së, DTL-së dhe Drejtoritë Rajonale, për problematika të ndryshme në lidhje me furnizimin me energji elektrike të gjithë përdoruesve të rrjetit.

Gjithashtu është mbajtur korrespondence e vazhdueshme me Departamentin Ligjor për problematika të ndryshme, ku ka qënë e nevojshme opinion i tyre për të patur procedura sa më të qarta dhe të sakta nga ana ligjore. Është realizuar monitorimi mbi zhvillimet në rrjetin shpërndarës dhe janë përditesuar problematikat në lidhje me zbatimin e Kodit të Shpërndarjes. Janë reflektuar ndryshimet e kryera në Kodin e Rrjetit dhe Kodin e Transmetimit dhe propozon ndryshimet e nevojshme në Kodin e Shpërndarjes.

Sipas kërkesave janë berë dhe dërguar komentet e nevojshme në lidhje me raportet e dërguara nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, sa i perket problemeve teknike që perballet Sistemi i Operimit, është innciuar dhe po vijon puna per institucionalizimin e adresave për njoftimet në rastet e ndërprerjeve në rrjetin shpërndarës. Vijon puna për përditesimin e të dhenave teknike për Rrjetin Shpërndarës në programin Power Factory.

Vëmendje ka edhe procesi për përfundimin e projektit në zbatim të urdherit të administratorit të kompanise OSSH sh.a.mbi unanzimet e fiderave TM ndërmjet dy nënstacioneve, reduktimin e një niveli tensioni në nëstacionet me tre nivele tensioni si dhe kalimin nga niveli 6,10kV ne ate 20 kV në nëstacionet ku ka mundesi. Janë realizuar në menyre korrekte të gjitha aktivitetet e tjera administrative.

Objektivat për vitin 2024

- Hartimi dhe miratimi i Kodit të ri të Shpërndarjes.
- Implementimi i SCADA qëndrore me KfW.
- Trajnime të ndryshme për stafin për teknologjite e reja që implementohen.
- Ri-strukturimi i Departamentit të Oprimimit sipas draftit të dorëzuar.
- Ri-strukturimi i Drejtorive Rajonale për të mundësuar ndarjen e procesit të Operimit nga ai i Mirëmbajtjes.
- Vijimi i punës për evidentimin e problematikave të ndryshme të rrjetit(TL/TM/TU) dhe raportimi i tyre në sektoret përkatës për marrjen e masave për nderhyrje.
- Përmiresimi i treguesve të cilësise së rrjetit (SAID/SAIF) bazuar në planin e investimeve dhe planin e mirëmbajtjes. SAIF -4.4%; SAID- 3.1%
- Bashkërendimi i punës me drejtorite rajonale për menaxhimin me të mirë të rrjetit TM/TU dhe të burimeve gjeneruese të lidhur në këtë rrjet dhe njoftimet paraprake të gjeneruesve në raste avarie apo remontesh të fidrave.
- Vijimi i punës për plotesimin e të dhenave në sistemin power Factor.
- Vijimi i trajnimit të personelit të Dispecerise TL dhe jo vetem për sistemin SCADA.

Së fundmi vlen të theksohet se përgjatë 3 viteve të fundit 2019-2022, gjëndja financiare e kompanisë, për shkak të ngjarjeve të jashtëzakonshme të ndodhura (tërmet 2019, pandemia), të shoqëruara me shpalljen e gjëndjes së emergjencës, nuk ka mundësuar kryerjen e investimeve të domosdoshme për përmirësimin e treguesve të cilesisë së furnizimit me energji elektrike. Ndërhyrjet në rrjetin shpërndarës kanë konsistuar më së shumti në kryerjen e mirëmbajtjes së nevojshme të rrjetit shpërndarës si dhe zgjidhjen e problemeve të emergjencës.

16. INVESTIME TË KRYERA NË RRJET SIPAS PLANIT TË INVESTIMEVE DHE REMONTET E KRYERA

Plani i miratuar i investimeve me Vendim të Këshillit Mbikqyrës nr. 27 datë 20.11.2023, përfshin investime të reja dhe në mirembajtje për infrastruktura si: Nënstacione, Linja TL, TM, TU, teknologji të reja, shërbime si mbikqyrje - kolaudim etj. Buxheti i parashikuar për periudhën 2023 – 2024 – 2025, jepet në vlera përmblendhëse si më mëposhtë:

Viti	2023	2024	2025
Buxheti (ALL pa TVSH)	2,800,477,636	3,061,487,079	2,120,233,726

Për vitin 2023 OSSH sh.a ka kontraktuar sipas planit të investimeve një total prej 3,293,630,142 ALL pa TVSH, 90% e këtyre kontratave janë lidhur gjatë 6 mujorit të dytë të vitit 2023, kjo për shkak të hartimit të plotësimit të procedurave të prokurimit publik.

Aktualisht gjatë vitit 2023, janë realizuar 7% e investimeve të reja për kontratat e lidhura gjatë këtij viti sipas planit për 2023, kjo përkthyer në vlerë 230,554,110 ALL pa TVSH. Ndërsa 93% e vlerës së kontraktuar gjatë 2023 nga plani i investimeve pritet të realizohet në vijim të 2024 – 2025.

Kontratat e lidhura gjate 3 mujorit të fundit të 2023, e që mbajnë peshën më të lartë të buxhetit të realizimit në terma financiare aktualisht nuk kanë filluar ekzekutimin e tyre në teren, për shkak të procedurave të pajisjes me Leje Ndërtimi (në AZHT) nga KKT.

Zbatimi në terren i këtyre investimeve pritet të fillojë gjatë vitit 2024 në 6 mujorin e parë të tij. Parashikohet që rreth 30% e vlerave të kontraktuara gjatë 2023 të realizohen në vijim të vitit 2025.

Bazuar në Rregulloren e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, Instalimet dhe Paisjet Elektrike, për të gjithë njësitë e rrjetit parashikohet dhe kryhet mirëmbajtje periodike. Rrjeti i shpërndarjes i nënshtrohet gjithashtu edhe mirëmbajtjes emergjente, si pasojë e ndryshimeve klimaterike të thella dhe emergjencave civile të llojeve të ndryshme për të eliminuar nyjet kritike që janë pasojë e ndryshimeve klimaterike (rrjeti shpërndarës është relativisht ajror, i amortizuar dhe i gjatë, në një terren malor, rrjedhimisht është i zbuluar ndaj kushteve klimaterike). Kjo e theksuar sidomos në zonat rurale dhe rurale të thella.

Raporti i Pajtueshmërisë 2023

OSSH

I gjithë ky proces i mirëmbajtjes kryhet me dhe pa ndërprerje të energjisë në përputhje me kërkesat e Kodit të Shpërndarjes dhe Transmetimit, lidhur me informimin nëpërmjet zyrave të shtypit të të gjithë përdoruesit e energjisë elektrike sipas njoftimeve paraprake. Në rastin e kryerjes me ndërprerje të energjisë, këto ndërprerje quhen ndërprerje të planifikuara. I gjithë procesi i mirëmbajtjes kryhet mbi bazën e një parashikimi vjetor të detajuar sipas muajve.

Për të pasur një panoramë më të qartë dhe të kuptueshme të rrjetit shpërndarës e paraqet si më poshtë:

- Mirëmbajtja në rrjetin shpërndarës 6,10,20,35 kV, mirëmbajtja e rrjetit të vjetër ajror.
- Mirëmbajtja e Nënstacioneve, mirëmbajtja e nyjeve TL
- Mirëmbajtja e kabinave elektrike TM/TU, mirëmbajtja e nyjeve TM.

Theksojmë që i gjithë procesi i mirëmbajtjes së rrjetit shpërndarës duke qënë se vetë rrjeti është dinamik, bën që edhe procesi i mirëmbajtjes është i planifikuar të mos jetë statik por edhe ai të jetë dinamik në varësi nga ndryshimet klimaterike që rrisin edhe kërkesën për konsum, por që mbart pasojat e këtyre ndryshimeve klimaterike nga pikpamja e qëndrueshmërisë, sidomos elektrodinamike.

Realizimi i Remonteve totale për vitin 2023 është si mëposhtë:

DREJTORIA	Planifikim+Realizimi i Remonteve TOTAL (Të Mesme + Profilaktike)									
	KABINA (në copë)		Linja te TM (Km)				Linja te TU (Km)			
			Kabllore		Ajrore		Kabllore		Ajrore	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
TIRANE	1173	1069	102.0	95.0	123.2	121.3	85.5	81.5	61.2	59.1
DURRES	1895	1019	85.0	78.0	168.4	160.3	70.0	63.0	15.5	13.2
SHKODER	390	356	41.9	35.6	238.2	222.2	46.6	38.1	239.2	218.9
BURREL	1234	1204	55.1	55.2	839.5	750.0	116.5	105.2	582.3	530.0
KUKES	535	284	15.0	7.0	1500.3	946.0	31.0	27.0	54.0	27.0
ELBASAN	626	583	28.0	25.1	62.8	63.0	32.0	28.7	34.0	30.2
KORÇE	451	350	15.5	14.5	243.2	215.9	16.2	13.2	159.3	137.3
BERAT	1261	1075	20.0	19.0	675.2	604.5	28.0	24.5	55.5	54.6
GJIROKASTER	797	580	84.3	65.8	1084.6	778.8	148.8	105.6	531.1	412.4
FIER	803	468	21.2	18.0	713.0	379.1	122.7	91.1	446.1	352.2

Raporti i Pajtueshmërisë 2023

OSSH

VLORE	678	628	21.0	16.0	448.4	437.9	15.2	14.1	49.8	48.1
TOTAL OSSH (R.Mesëm + R.Profilaktik)	9843	7616	489.0	429.2	6096.6	4679.0	712.4	592.1	2228.0	1882.9

17. INFORMACION MBI LIDHJET E REJA NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES

Për përmiresimin e procesit të lidhjeve të reja u ngrit një grup nga OSHEE Group sha për derregullimin dhe dixhitalizimin e shërbimeve, ku ndër të tjera u dakortësua për bashkimin e disa hapave në sistemin M-Power tek moduli i lidhjeve të reja pa cënuar procesin dhe duke përmirësuar shërbimin.

OSHEE Group ka promovuar një portal të ri e të aksesueshëm për të gjithë klientët e OSSH, me qëllim marrjen e shërbimeve online në formën më të shpejtë e më praktike të mundshme. Është zgjeruar gama e shërbimeve që do të ofrohen online, pa qenë nevoja të humbasësh kohë në sportelet e Kujdesit ndaj Klientit, vendim ky që e për afrofron OSHEE-në me standardet bashkëkohore.

“Lidhja e re” ose ofrimi i shërbimit të lidhjes së kontratës me OSHEE-në do të ofrohet online në website www.oshee.al dhe www.ossh.al brenda muajit shkurt 2024. Ky është njëri nga shërbimet më të kontestuara nga klientët tanë, për shkak të praktikave që çonin në zvarritje dhe humbje kohe, për të mos thënë edhe kosto ekonomike, prandaj OSHEE e vendosi në fokus të reformës së derregullimit.

Në website e ri abonenti mund të ndjekë hap pas hapi të gjithë procesin e aplikimit për shërbimin e kërkuar, në cilën fazë ndodhet, deri në marrjen e përgjigjes/shërbimit. Mjafton të vendosesh kodin dhe mund ta gjurmosh çështjen përmes platformës online, për të cilën kemi punuar deri në detaj, që klientët ta kenë sa më të thjeshtë përdorimin.

Gjithashtu tek dokumentacioni që dorëzohet nga aplikanti për lidhjet e reja për sektorin 0-20 kW (i cili perben rreth 85 % të aplikimeve) u propozua që tek RREGULLORJA PËR LIDHJET E REJA NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES Miratuar me Vendimin Nr.166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, e ndryshuar me Vendimin Nr.177, datë 08.11.2016 të Bordit të ERE te hiqen e pikat 4 “Fotokopje e certifikatës së rregjistrimit” 5 “Genplani i vendndodhjes së objektit “ dhe 6 “Deklaratë instalimi dhe protokoll tokzimi” dhe do të zëvendësohen me “Vetëdeklarim nga aplikanti”. Arsyeja e këtij zëvendësimi bëhet për të eliminuar dokumentacion që përgatitet nga palë të treta dhe ka kosto shtesë për aplikantin, duke shkurtuar njëkohësisht edhe kohën e aplikimit.

Për të gjitha aplikimet që bëhen nga subjektet të hiqet certifikata e rregjistrimit, për të gjitha fuqitë, pasi është një dokument i tepërt në një kohë që me NUIS, OSSH-ja mund të gjenerojë nga QKB-ja direkt cdo lloj informacioni të nevojshëm për aplikimin.

Raporti i Pajtueshmërisë 2023

OSSH

Gjatë viti 2024 do të realizohet mundësia e aplikimit nëpërmjet website-it dhe sistemi tracking nga aplikanti.

1-Aplikimet totale të regjistruara gjatë vitit 2023 për lidhje të re dhe shtesë fuqie sipas kategorizimeve të fuqive figurojnë si më poshtë:

Fuqia/Lloji i aplikimit	Lidhje e re	Shtese Fuqie	Grand Total
0-20KW	9613	1538	11151
20-50 kw	447	724	1171
Mbi 50 KW	500	645	1145
Grand Total	10560	2907	13467

2- Aplikimet totale të regjistruara gjatë vitit 2023 për lidhje të re dhe shtesë fuqie sipas kategorizimeve të rajoneve dhe fuqive figurojnë si më poshtë:

Rajoni/Fuqia	0-20 kw	20-50 kw	mbi 50 kw	Grand Total
Drejtoria Rajonale Berat	427	63	59	549
Drejtoria Rajonale Burrel	427	13	33	473
Drejtoria Rajonale Durrës	2161	186	176	2523
Drejtoria Rajonale Elbasan	708	64	73	845
Drejtoria Rajonale Fier	410	54	40	504
Drejtoria Rajonale Gjirokastrë	762	117	71	950
Drejtoria Rajonale Korçë	527	40	46	613
Drejtoria Rajonale Kukës	197	16	11	224
Drejtoria Rajonale Shkodër	1115	93	92	1300

Raporti i Pajtueshmërisë 2023

OSSH

Drejtoria Rajonale - Tiranë	3441	395	464	4300
Drejtoria Rajonale Vlorë	976	130	80	1186
Grand Total	11151	1171	1145	13467

Statusi i aplikimeve	Numri i aplikimeve
Raste ne te cilat aplikanti duhet te plotesoje dokumentacionin	1394
Perfunduar	8692
Pritet të bëhet pagesa e preventivit nga abonenti	688
Proces	1530
Refuzuar	1163
Grand Total	13467

Për rastet e pambyllura brenda afateve kryesisht kanë ndikuar faktorët si më poshtë:

- Koha e plotësimit të dokumentacionit nga abonenti (në raste që konstatohen mungesë dokumentacioni)
- Mosprezenca e abonentit në objekt, gjatë azhurnimit teknik.
- Pagesa e abonentit e cila duhet të kryhet brenda një afati 5 ditor
- Kohëzgjatje e kryerje së përfundimit të punimeve nga abonenti (përfundimi i objektit shtrirja e linjes etj)

Për këto problematika, afati kohor nuk është në varësi të OSSH sha por nga faktorë të tjerë të jashtëm.

Për rastet e miratuara përtej afateve të percaktuara në rregullore ka patur ankesa:

Arsyet e aplikimeve të kaluara ne” hold” dhe të “refuzuara” gjatë vitit 2023 vijon si më poshtë:

Mungesë dokumentacioni, nuk është kryer pagesa e preventivit për një kohë të gjatë, aplikanti rezulton debitor, objekti për të cilin është aplikuar është i papërfunduar dhe probleme mbi pronësinë.

Sektori i Burimeve Gjeneruese

Ky sektor, në zbatim të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, VKM-së Nr. 822/2015, zhvillon procedurat për miratimet e lidhjeve në rrjetin e shpërndarjes, të burimeve të reja gjeneruese 9 (opinionet paraprake dhe miratimet e pikes se lidhjes). Gjithashtu, referuar udhëzimit Nr. 3, datë

Raporti i Pajtuëshmërisë 2023

OSSH

20.6.2019 “Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli”, sektori i burimeve gjeneruese ndjek procedurat për miratimet e lidhjeve në rrjetin e shpërndarjes të konsumatorëve vetëprodhues me qëllim integrimin e tyre në rrjetin e shpërndarjes së OSSH sh.a.

Veprimtaria e Sektorit të Burimeve Gjeneruese për vitin 2023 përqëndrohet në tre drejtime kryesore, duke ndjekur edhe të gjithë detyrat e tjera funksionale që mbulon Drejtoria e Ofrimit të Rrjetit:

- Integrimi i konsumatorëve vetëprodhues në rrjetin e OSSH sha (bazuar në udhëzimin Nr. 3, datë 20.6.2019)
- Dhënia e opinioneve paraprake (bazuar në vendimin Nr. 822, datë 7.10.2015)
- Miratimet e pikës së lidhjes së burimeve gjenerues (bazuar në Ligjin Nr. 43/2015 i ndryshuar dhe Ligjin Nr. 7/2017)

1. Integrimi i konsumatorëve vetëprodhues në rrjetin e OSSH sha

Qeveria Shqiptare ka bërë shumë për të ndihmuar konsumatorët pasivë të bëhen prodhues aktivë të energjisë. Kjo përfshin lehtësimin e tyre për t'u lidhur me rrjetin energjetik dhe sigurimin që cilësia e energjisë së prodhuar nga prodhuesit të mos kufizohet vetëm në cilësinë e konsumatorëve të tyre. Kjo ka rritur interesin për këtë praktikë në Shqipëri. Nevoja për më pak energji me bazë karboni po i kthen konsumatorët pasivë të energjisë në prodhues aktivë të energjisë. Ky ndryshim në rol është një mundësi jo vetëm për një sistem energjie më të qëndrueshëm me më pak emetime karboni, por edhe për një sistem më demokratik dhe gjithëpërfshirës.

Nga ana e sektorit të burimeve gjeneruese vazhdon puna në lidhje me integrimin e kësaj kategorie prodhuesish në tregun e energjisë elektrike. Gjatë vitit 2023 vihet re një rritje në lidhje me numrin e klientëve të cilët kanë aplikuar për lidhje të re në cilësinë e vetëprodhuesit të energjisë elektrike të cilët mund të instalojnë një kapacitet total deri në 500 kWp, në përputhje me nenin 15, të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

Për vitin 2023 janë mirtuar 627 klientë vetprodhues që e kanë këtë status aktualisht, me një kapacitet total të instaluar rreth 60596.26 kWp nga kjo kategori prodhuesish.

Drejtoria rajonale	Numri i veteprodhuesve 2022	Fuqia e instaluar (kW)
Tiranë	267	22245.95
Durrës	152	16656.79
Fier	23	2433.45
Vlorë	14	563.71

Raporti i Pajtueshmërisë 2023 OSSH

Gjirokastrë	14	877.84
Korçë	33	3076.96
Elbasan	69	5163.28
Burrel	10	442.92
Berat	66	4153.58
Shkodër	66	4352.29
Kukës	9	593.04
Totali	723	60596.26

Numri i konsumatorëve vetëprodhues dhe fuqia totale e instaluar në kWp të lidhur në rrjetin e OSSH sipas drejtorive rajonale, viti 2023



Grafiku i numrit total të konsumatorëve vetëprodhues të lidhur në OSSH (ndarje në % sipas Drejtorive Rajonale), viti 2023


2. Dhënia e opinioneve paraprake

Spektori i Burimeve Gjeneruese është përgjegjës për garantimin e aksesit në rrjet dhe miratimin e lidhjeve të reja konform rregullave teknike e ligjore në përputhje me kërkesat e vendosura tek Ligji Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, aktet e tjera ligjore në fuqi si dhe Kodin e Rrjetit të Shpërndarjes. Përdoruesi i sistemit të shpërndarjes që kërkon të lidhet me Rrjetin e Shpërndarjes duhet të plotësojë kriteret teknike minimale të planifikimit dhe operimit, me qëllim që të ruhet një shfrytëzim i qëndrueshëm dhe i sigurtë i Sistemit të Shpërndarjes. Bazuar në VKM-në Nr. 822/2015, neni 10, Studimi i Parafisibilitetit, ku thuhet se subjekti kërkues për lidhje në rrjetin e shpërndarjes të burimit të ri gjenerues, paraqet një kërkesë pranë OSSH sha për Opinion Paraprak mbi lidhjen e tij me sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike. Përgjatë periudhës Janar- Dhejtor 2023, OSSH sha ka dhënë 42 Opinione Paraprake (faza e parë për marrjen e miratimit paraprak në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjitikës) për lidhjen në rrjetin e saj të Burimeve të Reja Gjeneruese.

Opinione Paraprake (ndarje sipas Drejtorive Rajonale), Viti 2023

Drejtoria Rajonale	Opinion paraprak	Fuqia MW
Vlore	2	26.5
Berat	3	9
Burrel	5	15.5
Durres	3	20
Elbasan	7	31
Fier	11	54.25
Korce	3	20.8
Kukes	2	18.1
Librazhd	2	12
Lezhe	1	2.3
Shkoder	2	6
Gjirokaster	1	15
Totali	42	230.45

Opinione Paraprake (grafik sipas drejtorive rajonale), Viti 2023



Raporti i Pajtuëshmërisë 2023

OSSH

3. Miratimet e pikës së lidhjes së burimeve gjenerues

Gjatë vitit 2023, bazuar në VKM-në Nr. 822/2015, sektori i burimeve gjeneruese ka dhënë 29 miratime për burime gjeneruese të energjisë elektrike (8 miratime për HEC-e, 19 për parqe fotovoltaike, 2 për eolike).

Lloji I Gjeneruesit	Numri I miratimeve	Fuqia e instaluar e gjeneruesit MW
Eolik	2	17
Fotovoltaik	19	53
HEC	8	21.39
Totali	29	91.39

Miratimet e dhëna nga sektori i burimeve gjeneruese të ndara sipas nënstacioneve per Vitin 2023

Pika e lidhjes (zbara nst ose linje 35 kV)	Opinion paraprak	Fuqia MW
110/10 kV Shupenze	1	2
110/20 kV Fieri I Ri	1	2
110/35/10 kV Kukës.	1	15
110/35/6 kV Bulqizë	4	14
110/35/6/0.4 kV Tec-Ballsh	1	6
110/6 kV Fushë Krujë	1	8
35/6 kV Poliçan	2	4
Delvine	1	6
Fier	1	4
Hoxhare e re	2	5
Jagodine	1	2
Kafaraj	1	5
N/St Librazhd 110/35 kV	2	12
N/St 35/6 kV Elbasan 5	5	18
N/St Himarë 110/35/20 kV	1	14
N/St Kurbnesh 110/6 kV	1	2
Petrushe 35/10 kV	1	13
Pojan 35/6 kV	3	14
Povelç 35/6 kV	1	10
Rrogozhine	1	2
Shijak	1	2
Shkodra 2 110/35/20/6 kV	1	4
Trush 2 35/6 kV	1	2

Raporti i Pajtueshmërisë 2023

OSSH

Qarr 35/6 kV	1	6
L 30-34 (Kafaraj-Povelce)	1	2
Sallmone 110/20 kV	1	10
L30-12/1 Hoxhara 2- TEC Fier	1	9
Orikum 110/35/20 kV	1	13
Delvinë 35/10 kV	1	15
Banjë 35/6 kV	1	11
Totali	42	230

Duke qenë se ndërtimi i impianteve kryesisht fotovoltaike por edhe eolike shikohet si një alternativë më e mirë dhe ekonomike (kjo falë edhe pozitës së favorshme gjeografike të Shqipërisë) për sa i përket prodhimit të energjisë elektrike, lind nevoja e një studimi të detajuar për impaktin që këto impiante gjenerimi sjellin në rrjetin e shpërndarjes dhe kjo mund të përmendet si një nga problematikat kryesore që i përkasin sektorit të burimeve gjeneruese.

Gjithashtu mund të përmendim faktin që duke qenë se vemendja po kalon drejt kësaj forme të prodhimit të energjisë, lind nevoja që për mbarëvajtjen e këtij sektori të bëhet një rifreskim i rregullores së lidhjeve të reja për dokumentacionin e nevojshëm dhe procedurat që duhen ndjekur për miratimin e pikës së lidhjes së burimeve gjeneruese.

18. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË ZYRTARIT DHE REKOMANDIMET

Kjo pjesë e raportit paraqet masa e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të lena nga ZP në raportin e vitit 2022.

- Përditësimi i faqes zyrtare të OSSH dhe krijimi i një brendi të ri më fleksibël e cila është arritur falë bashkëpunimit shumë të mirë ndërmjet Administratorit të Shoqërisë, Zyrtarit dhe akorët e tjerë për krijimin e kësaj faqe shumë dinjitoze është ri-dizenjuar, duke përmirësuar menyren e dhënies dhe organizimit të informacionit të duhur sipas fushave të caktuara që operon, duke bërë një prezantim më të mirë, menaxhimin e duhur të informacionit të rëndësishëm si dhe pajtueshmërinë me standardet e sigurisë që aplikohen për sistemet e informacionit në WEB.
- Vendosja e Programit të Pajtueshmërisë dhe raportit vjetor në Web të Shoqërisë, synon informacin adekuat për të gjithë punonjësit e OSSH për tu informuar dhe për të zbatuar programin e pajtueshmërisë
- Krijimin e një rubrike të re në Website OSSH Njofto/Raporto te Zyrtari ku do të adresohen nëpërmjet email në menyre konfidenciale për çështje që mund të lidhen me veprimtari joetik duke përfshirë: konflikt interesin, rrjedhje informacioni sensitiv, trajtimi diskriminues i përdoruesve të sistemit, mosrespektimi i programit të pajtueshmërisë etj.
- Trajnime dhe takime me stafin për të bërë progres sa më efikas. Oficeri Pajtueshmërisë ka organizuar një nga trajnimet më të rëndësishme në Rajonin e Tiranës, I cili është merajoni me ndikim më të madh në vend, ku punonjësit e OSSH janë informuar dhe këshilluar për cdo çështje që lidhet me Programin e Pajtueshmërisë etj.

- Miratimi i struktues së re sipas ligjit në fuqi, në bashkëpunim me Administratoret e Kompanisë OSSHE Group/OSSH Sha është ngritur një grup pune për të bërë një strukturë me produktive në të gjitha Rajonet e Vendit ku do të kërkohet një punë me cilesore në mirëmenaxhim.

18.1 Rekomandimet e Zyrtarit të Pajtueshmërisë;

Njoftim zyrtar dhe pjesmarrja e ZP ne mbledhjet e Këshillit Mbikqyres;

Ky detyrim lind nga përcaktimet e Programit të Pajtueshmërisë së OSSH Pika 2 dhe duke marrë parasysh faktin që gjatë vitit 2023 ZP nuk është njoftuar mbi mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës, rekomandoj që strukturat përkatëse të OSSH të njoftojnë zyrtarisht ZP për pjesëmarrje në mbledhjet e Këshillit dhe vecanërisht ato të mund të ndërlidhen me çështje të tilla si: kushtet e aksesit në sistemin e shpërndarjes, si dhe të përdorimit të këtij rrjeti, alokimin e kapaciteteve të shpërndarjes, transparenca, projektet në zbatim lidhur me operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, blerjen dhe shitjen e energjisë për nevoja të mbulimit të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, etj. Dua të theksoj që kam pasur disa takime me Kyetarin dhe Antaret e Këshillit Mbikqyres dhe kemi shkëmbyer mendime në lidhje me projektet dhe progresin që kompania do të ketë në të ardhmen.

Trajnimet në lidhje me konfidencialitetin e të dhënave/informacionit të ndjeshem dhe e drejta e informimit;

Në funksion të përmbushjes së parashikimeve të ligjit për sektorin e energjisë dhe përcaktimeve të Programit të Pajtueshmërisë për ruajtjen e konfidencialitetit të dhënave/informacionit të ndjeshem tregtar, është e rëndësishme kryerja e trajnimeve të vazhdueshme me të gjithë punonjësit e OSSH dhe vecanërisht me ato punonjës që kanë të drejta aksesit në platformat elektronike të OSSH.

Përditësim/përmirësim i Programit;

Programi është një produkt i ri dhe kërkon përditesohet dhe të mbahet në vëmendje që të jetë sa më efikas dhe koherent me të gjithë aktorët që në bashkëpunojmë.

Zgjerim i shërbimeve online/trasparent për abonentët;

Në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet OSHEE Group dhe OSSH është bërë një progres në lidhje me zhvillimin e përmirësimeve të marrëdhënive me klientin përmes portalit dhe Website të Kompanisë.

Hartimi dhe miratimi i Kodit të ri të Shpërndarjes;

Ky rekomandim buron nga kërkesa dhe detyrimi që OSSH ka për miratim e ri të Kodit të Shpërndarjes pasi është që prej vitit 2008, dhe kërkes konkrete nga Sekretariti i Energjisë të bërë në raportin e fundit dhe ERE, por duhet theksuar që janë marrë të gjitha masat e nevojshme që të realizohet shume shpejt, për këtë janë ngritur grupe pune për të bërë të mundur hartimin e Kodit të Shpërndarjes dhe publikimin në faqen zyrtare www.osshe.al si dhe më gjërë në organet kompetente.

19. KONKLUZIONE

OSSH është duke punuar fort për të kryer punë cilësore dhe për të arritur objektivat kryesore, duke theksuar progresin në uljen e humbjeve në rrjet dhe pritsshmëritë e larta që stafi drejtues ka për vitin në vazhdim.

Një nga objektivat kryesore të OSSH-së është të sigurojë mbarëvajtjen e menaxhimit për të garantuar akses të vazhdueshëm në energjinë elektrike në rrjetin e shpërndarjes për të gjithë përdoruesit e tij. Shqipëria ka bërë një rrugë të gjatë dhe përpjekje të konsiderueshme për të siguruar ndarjen e operatorit të sistemit të shpërndarjes.

Në këtë drejtim Sekretariati mbyll çështjen ECS-4/17 e cila u hap në 16.01.2018 për të përmbushur të gjitha detyrimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe në datën 18.04.2023 Sekretariati e pranon se është ezauruar pas traspozimit të plotë të dispozitave të Direktivës së Energjisë Elektrike në lidhje me ndarjen e OSSH në Legjislacionin Kombëtar, përfundimin e ndarjes ligjore dhe progresit thelbësor në ndarjen funksionale. Masat e fundit që sigurojnë ndarjen funksionale ishin miratimi i programit të përputhshmërisë dhe emërimi i një zyrtari të përputhshmërisë dhe të vlerësuar me përmbushje 100% të njërit prej objektive kryesore të OSSH/DSO UNBUNDLING siç thuhet në raportin vjetor të mbajtur më 14.12. 2023 në Vjenë.

Zyrtari i Pajtuëshmërisë ka pasur akses të pakufizuar në të dhënat e nevojshme në zyrat e OSSH-së për të kryer detyrat e tij. Zyrtari i Pajtuëshmërisë ka marrë pjesë në shumicën e mbledhjeve të drejtuesve të OSSH dhe Organeve Korporative, përfshirë Organet Mbikqyrese dhe Drejtuese, të cilët e kanë informuar Zyrtarin e Pajtuëshmërisë paraprakisht për takimet e programuara dhe i ka siguruar të gjithë informacionin dhe materialet e nevojshme për të marrë pjesë në takime. Gjatë kryerjes së aktiviteteve të tij, Zyrtari i Pajtuëshmërisë ka dhënë opinionin e tij në lidhje me disa dokumenta të brendshëm si dhe veprime të OSSH në lidhje me pajtuëshmërinë e tyre. Të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e OSSH, përfaqësuesit e autorizuar, audituesit dhe këshilltarët kanë konfirmuar me shkrim që janë të informuar për Programin dhe që do ta zbatojnë atë. Të gjithë drejtuesit e OSSH dhe punonjësit janë udhëzuar rregullisht për zbatimin e këtij programi të paktën një herë në vit.

Raporti i vitit 2023 nuk nxjerr në pah asnjë shkelje materiale që rezultojnë në mospërputhje me ndonjë nga kërkesat e pajtuëshmërisë që do të rrezikonte (i) pavarësinë e OSSH nga kompanitë vertikalisht të integruara që kryejnë ose janë të angazhuara në aktivitetet e prodhimit ose furnizimit të energjisë (FSHU, FTL etj) (ii) konfidencialitetin e të dhënave dhe informacioneve të ndjeshme tregtare si dhe (iii) trajtimin e barabartë të përdoruesve të sistemit të shpërndarjes siç e kemi cituar më sipër.

Është e rëndësishme të përmendet se përmbushja e kërkesave të përcaktuara në Programin e Përputhshmërisë kërkon bashkëpunim të ngushtë dhe të vazhdueshëm me të gjitha departamentet dhe menaxherët për të identifikuar dhe parandaluar në kohë sjelljet diskriminuese ndaj pjesëmarrësve në sektorin e energjisë.

OSSH sh.a. si dhe OSHEE, nën dijeninë e Zyrtarit të Pajtuëshmërisë, janë në komunikim të rregullt me ERE për plotësimin e kërkesave ligjore. Zyrtari i Pajtuëshmërisë është marrë me koordinimin e komunikimit me ERE në lidhje me programin ku ku u zhvillua një seancë dëgjimore në ambjentet e

Raporti i Pajtueshmërisë 2023

OSSH

ERE me përfaqësues të OSSH sha, me autoritetet e tjera kompetente dhe Grupin Koordinues të Operatorëve të Sistemit të Shpërndarjes (ECDSO-E), Rrjetin e Zyrtarëve të Pajtueshmërisë në Rajon. Në të njëjtën kohë, Zyrtari i Pajtueshmërisë prezantoi për herë të dytë Propozimet/Rekomandimet për zbatimin më korrekt të Programit të Pajtueshmërisë dhe kuadrit rregullator të OSSH, si përditësimin e website online duke përfshirë Programin e Pajtueshmërisë, dhe zbatimin të menjëhershëm të Udhëzuesit të Politikave të Klasifikimit të Informacionit sipas Programit.

OSSH ndan të dhëna dhe ka një bashkëpunim shumë të mirë kryesisht me OST, Organin Rregullator (ERE), Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Institutin e Statistikave, Organizatat ku OSSH është partner apo organizata që ofrojnë asistencë financiare për zhvillimin e sektorit të energjisë.

Si përfundim, duhet përmendur bashkëpunimi shumë i mirë ndërmjet Zyrtarit të Pajtueshmërisë me të gjitha njësitë organizative të OSSH dhe OSHEE si dhe Stafin, Drejtorët, Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, strukturat përkatëse të ERE dhe MIE.

Tiranë, Mars 2024

Ervis Hazizi

Zyrtari i Pajtueshmërisë OSSH Sha



sekretaria@ere.gov.al

From: Elton B. Radheshi <eradheshi@ere.gov.al>
Sent: Wednesday, March 27, 2024 5:54 PM
To: Oriana Kallaku
Cc: 'plika'; btavani@ere.gov.al; 'Erjola Sadushi'; 'Eva Hyna'; sekretaria@ere.gov.al; 'Bledar Qira'
Subject: FW: Emailing: OSSH NR.828 V2024
Attachments: OSSH NR.828 V2024.pdf

Ne vemendjen tuaj

-----Original Message-----

From: sekretaria@ere.gov.al <sekretaria@ere.gov.al>
Sent: Wednesday, March 27, 2024 2:31 PM
To: Elton B. Radheshi <eradheshi@ere.gov.al>
Subject: Emailing: OSSH NR.828 V2024

TONI VIJON SE KA VOLUM,
ESHTE DHE VERSIONI NE ANBLISHT PE E DERGOJ PAS PAK

Your message is ready to be sent with the following file or link attachments:

OSSH NR.828 V2024

Note: To protect against computer viruses, e-mail programs may prevent sending or receiving certain types of file attachments. Check your e-mail security settings to determine how attachments are handled.